

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5548  
E premte, 10 gusht 2018  
çmimi 0.40 €

## Presidenti Thaçi emëron gjuqtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

#### KOMBET E VOGLA, FIGURA TË MËDHA F.11

Shkruan:  
Agron HOTI



#### BASHKIMI I LUGINËS SË PRESHEVËS ME KOSOVËN, ÇËSHTJE QË OBLIGON TË GJITHË, PA PËRJASHTIM F.11

Shkruan: Shaqir SHAQIRI



#### KRYEPROKURORI KËRKON VERIFIKIM TË ÇDO MOSVEPRIMI PARA VRASJES NË GJAKOVË F.6

### EKONOMI

#### PUSHKOLLI: DËMET NGA AUTOMJETET E PASIGURUARA KAPIN SHIFRËN MBI 27 MILIONË EURO F.9

#### POSTA PROMOVON DY PULLA POSTARE ME IMAZHET E EPRORËVE TË UÇK-së F.9

### SPORT

#### NË STADIUMIN 'ADEM JASHARI' NË MITROVICË DO TË INVESTOHEN RRETH 10 MILIONË EURO F.15

#### IPKO, SPONSORE GJENERALE E SUPERLIGËS DHE PËRFAQËSUES SË KOSOVËS F.18



FLET PËR "EPOKËN E RE" MINISTRI I TURIZMIT  
DHE MJEDISIT, BLENDI KLOSI F.4-5

## Shqipëria këtë vit po ofron risi në turizëm

- Kjo verë ka shënuar  
kthesë në shumë aspekte që  
ishin problematike e bartur  
në vite sa i përket turizmit

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë, Blendi Klosi, ka thënë se vetëm në muajin korrik mbi një milion shtetas të huaj kanë hyrë në Shqipëri, duke shënuar rritje rekord prej 19-përqindësh në krahasim me korrikun e vitit 2017. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Klosi ka pohuar se

këtë vit Shqipëria ka sjellë risi tek të gjitha zonat turistike. Ai ka treguar se është bërë mobilizim i madh te pikat e kalimit kufitar për t'i lehtësuar hyrjet, kurse në trafik për t'i lehtësuar lëvizjet dhe për të parandaluar aksidentet. Ndërkaq në plazhe thotë se kanë arritur një transformim radikal të situatës së

sigurisë. Pavarësisht prej përmirësimeve që janë bërë në turizëm, Kolosi ka thënë se janë të vetëdijshëm se duhet bërë edhe më shumë për të arritur në nivelin maksimal të potencialit turistik që ka Shqipëria. Ai ka bërë me dije se të hyrat e siguruar nga turizmi janë rritur për 10 për qind

## Veseli: Veriu do të jetë gjithmonë i Kosovës F.3

Asnjëherë në procesin e dialogut nuk do të jetë temë e diskutimit ndarja e Kosovës. Kështu ka deklaruar të enjten kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, gjatë një vizite në Stadiumin "Adem Jashari" në Mitrovicë. Ai ka përsëritur qëndrimin e tij se nuk do të ketë ndarje të shtetit të Kosovës. Sipas Veselit, sovraniteti dhe integriteti i shtetit janë të pacenueshëm



Merren masa  
disiplinore ndaj  
200 punonjësve  
shëndetësorë për  
mosrespektim të  
orarit të punës F.7

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curez-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Pritren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Ducich: KFOR-i nuk pret incidente në Kosovë



Prishtinë, 9 gusht - Komandanti i Grupit shumëkombësh luftarak lindje të KFOR-it dhe bazës ushtarake në Bondsteel, kolonel Nick Ducich, ka vlerësuar se gjendja e sigurisë është e qetë dhe stabile. Ai i ka thënë "Radios Contact Plus" se nuk priste ndonjë incident, por ka vënë në dukje se KFOR-i është gati të merret me çdo gjë që mund të jetë provokim. Pavarësisht prej tensioneve të pranishme në terren, të

shkaktuar nga një shumëllojshmëri e deklaratave dhe spekulimeve në medie për ndarjen e Kosovës, kolonel Ducich ka thënë se nuk pret incidente. "Së pari, KFOR-i po kryen operacione për ta demonstruar gatishmërinë tonë dhe ne e kryejmë atë në mënyrë efektive në tërë Kosovën, jo vetëm në veri. Mendoj se mund të themi se çdoherë e përmbushim misionin tonë dhe nuk pres ndonjë incident. Ne

jemi të gatshëm të merremi me gjithçka që mund të jetë provokim", ka thënë ai.

I pyetur nëse akuzat nga medie të caktuara se KFOR-i është duke trajnuar Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), komandanti i Kampit "Bondsteel" ka thënë se KFOR-i e trajton FSK-në, por vetëm në kuadër të mandatit të vet dhe ShBA-së si vend, e kjo kryesisht ka të bëjë me kompetencat kyçe.

## Scaparrotti: Pres që Maqedonia të bëhet anëtare e NATO-s

Gjenerali Scaparrotti, i cili udhëheq forcat ushtarake amerikane në Evropë dhe është komandant i forcave të NATO-s, ka thënë se Maqedonia është në rrugën e duhur për ndërtimin e një të ardhmeje të ndritur, duke theksuar se anëtarësimi i saj në NATO do të jetë në të mirë të rajonit, gjithashtu edhe në të mirë të të gjithë Evropës



Scaparrotti.

Ndërsa ministrja e Mbrojtjes së Maqedonisë, Radmilla Shekerinska, ka thënë se vizita e së enjtes e gjeneralit Curtis Scaparrottit, njëherësh e para e komandantit të forcave amerikane në Evropë dhe komandës së lartë të NATO-s për Evropë, tregon se sa shumë gjëra në Maqedoni po

ndryshojnë që nga marrja e ftesës për anëtarësim, që u bë më 11 korrik.

Shekerinska ka theksuar se gjatë referendimit qytetarët e Maqedonisë do të kenë mundësi të zgjedhin mes së ardhmes dhe izolimit. "Është me shumë rëndësi që këtë orientim që tanimë më shumë se dy dekada e kanë shpre-

hur qytetarët e Maqedonisë për anëtarësimin e vendit në NATO, ta konfirmojmë dhe sigurojmë. Ne, si Qeveri, si Ministri e Mbrojtjes po bëjmë gjithçka që është e mundur që ky proces të ecë pa pengesa dhe të ketë rezultat të suksesshëm. Si hap i parë kryesor do të jetë referendumi më 30 shtator", tha ajo. "Në referendum presim që qytetarët ta shohin interesin e tyre, interesin e Republikës së Maqedonisë, interesin e shtetit dhe interesin e gjeneratave të tjera dhe të votojnë pozitivisht. Zgjedhja është e qartë, për të ardhme apo izolim! Anëtarësim në NATO dhe BE apo edhe një dekadë e humbur", është shprehur Radmilla Shekerinska, ministre e Mbrojtjes së Maqedonisë, ndërsa ka shtuar se anëtarësimi në NATO inkurajon investitorët e huaj të investojnë në Maqedoni.

SHKUP, 9 GUSHT - Me padurim presim që Maqedonia të bëhet anëtarja e 30 e NATO-s, ka deklaruar në Shkup komandanti Suprem i NATO-s për Evropë, gjenerali Curtis Scaparrotti, i cili ka ndjekur edhe një stërvitje demonstruese të Armatës së Maqedonisë në Kazermën 'Ilinden' të Shkupit.

Gjenerali Scaparrotti, i cili udhëheq forcat ushtarake amerikane në Evropë dhe është komandant i forcave të NATO-s, ka thënë se Maqedonia është në rrugën e duhur për ndërtimin e

një të ardhmeje të ndritur, duke theksuar se anëtarësimi i Maqedonisë në NATO do të jetë në të mirë të rajonit, gjithashtu edhe në të mirë të të gjithë Evropës. "Janë bërë reforma të mëdha drejt rrugës për anëtarësim në NATO. Jemi të bindur se anëtarësimi në NATO do të jetë në të mirë të vendit tuaj. Të gjitha vendet, të cilat janë bërë pjesë e Aleancës, kanë arritur ta përforcojnë demokracinë e tyre, ta avancojnë sigurinë dhe ta bëjnë jetën e qytetarëve të tyre më të sigurt", ka deklaruar gjenerali Curtis

## Gjermania mbështet Shqipërinë për anëtarësimin në BE

TIRANË, 9 GUSHT - "Mekanizmi për verifikimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve është një kolonë mbështetëse e reformës së sistemit të drejtësisë në Shqipëri, e cila po mbështetet prej vitesh nga Gjermania", u shpreh të enjten për ecurinë e procesit të vetingut, ambasadorja gjermane Susanne Schütz.

Ambasadorja Schütz shton se e

përhëndet faktin që procesi i vetingut i nisur në muajin mars ka përparuar mirë. "Falë punës së rëndësishme të Komisionit të Pavarur të Kualifikimeve dhe përkrahjes së përkushtuar të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit u bë e mundur që në fazën e parë të vetingut të verifikohen shumë gjyqtarë dhe prokurorë, madje dhe të nivelit të



lartë. Jam e bindur se një proces verifikimi i pavarur dhe me standarde të njëjta do të ndihmojë në forcimin afatgjatë të shtetit ligjor dhe të besimit të shqiptarëve në sistemin e drejtësisë", tha ajo. "Prandaj është e rëndësishme të krijohen këshillat e lartë për plotësimin e vendeve vakante si dhe Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese të rimarrin sa më

shpejt të jetë e mundur aftësinë e tyre ligjore. Në këtë kuptim Gjermania do ta mbështesë edhe Shkollën e Magjistraturës në zgjerimin e kapaciteteve të saj arsimuese dhe kualifikuese. Gjermania qëndron krah Shqipërisë duke mbështetur vendin në rrugën drejt negociatave për anëtarësimin në BE", tha ambasadorja Schütz.

## Ndryshimi i emrit nuk i hap dyert e NATO-s dhe të BE-së

SHKUP, 9 GUSHT - Partia opozitare maqedonase OBRM-PDUKM përmes një kumtese ka akuzuar LSDM-në se për çdo ditë keqpërdor institucionet shtetërore. Nga kjo parti thonë se

shteti për 14 muaj është shkatërruar edhe në planin ekonomik, edhe në planin politik. "Qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë dëshmitarë se si Zaevi dhe LSDM-ja kryejnë

vjedhje të papara dhe keqpërdorim të resurseve shtetërore të cilat i mbulojnë me raste të projektuara. Në këtë mënyrë në BE dhe në NATO nuk shkohet. Zaevi i ka shitur interesat kombëtare

dhe shtetërore me qëllim për ta defokusuar publikun dhe që të mundet bashkë me bashkëpartiakët të pasurohen pa pengesë në kurriz të qytetarëve", thonë nga OBRM-PDUKM.





# Veseli: Veriu do të jetë gjithmonë i Kosovës

Asnjëherë në procesin e dialogut nuk do të jetë temë e diskutimit ndarja e Kosovës. Kështu ka deklaruar të enjten kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, gjatë një vizite në Stadiumin "Adem Jashari" në Mitrovicë. Ai ka përsëritur qëndrimin e tij se nuk do të ketë ndarje të shtetit të Kosovës. Sipas Veselit, sovraniteti dhe integriteti i shtetit janë të pacenueshëm

**EPOKA  
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 9 GUSHT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, të enjten ka përsëritur qëndrimin e tij se nuk do të ketë ndarje të shtetit të Kosovës. Gjatë vizitës që i ka bërë Stadiumit "Adem Jashari" në Mitrovicë, kryeparlamentari Veseli ka deklaruar se veriu do të jetë gjithmonë i Kosovës. Me këtë rast ai ka treguar se shumë shpejt do të fillojë ndërtimi i të gjitha shtëpive të djegura në veri, duke thënë se secili qytetar, pavarësisht prej kombësisë, mund të jetojë lirshëm ku të dojë në Republikën e Kosovës. "Nuk do të ketë ndarje të Kosovës asnjëherë. Në dialog nuk do të jetë temë e diskutimit ndarja asnjëherë. Ne jemi duke komunikuar në mënyrë që komunitetet të integrohen sa më mirë në shtetin tonë, në Republikën e Kosovës", ka thënë Veseli, duke shtuar se sovraniteti dhe integriteti i shtetit janë të pacenueshëm. "Kosova do të shkojë në dialog. Presim nga dialogu njohjen e shtetit tonë të pavarur dhe sovran, anë-

tarësimin në OKB, dhe ruajtje të partneritetit me ShBA-në dhe BE-në. Ky është qëllimi ynë. Çdo deklaratë tjetër, çdo qëllim tjetër, më tepër është lojë për të nxitur pasiguri, frikë dhe paqartësi, që më së paku u bënë dobi Kosovës dhe qytetarëve të saj", është shprehur Veseli.

Ndaj kësaj vizite të kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli dhe deklaratës së tij se 'Kosova nuk ka veri dhe jug, por është një', ka reaguar kryetari i Komunës së Mitrovicës dhe zëvendëspresidenti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Agim Bahtiri. Ai nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook" ka shkruar se Veseli ka bërë që Mitrovica të ndahet në veri dhe jug. "Kadri Veseli paska dalë këndej pari nga Mitrovica në Stadiumin Olimpik 'Adem Jashari'. Në vend se ta shikojë emrin e ndritur të komandantit dhe të frymëzohet për të bërë vepra të mira dhe të largohet nga injoranca, ky paska zgjedhur të tregohet injorant përsëri. Dua t'i them kryetarit të Kuvendit, se jug dhe veri nuk ka pasur Mitrovica, por ju e bëtë të jetë e tillë. Këtë e them sepse sot paskeni deklaruar që Kosova nuk ka veri dhe jug. Ajo është një", ka shkruar Bahtiri. Ai



ka thënë se mitrovicasit ndihen shumë mirë që nga koha kur PDK-ja nuk e qeveris më Mitrovicën. "Ju paskeni dalë në qytetin tuaj, aty ku jeni lindur dhe rritur. Më mbeti merak t'ju takoj për t'ju treguar se qytetarët e Mitrovicës ndihen shumë mirë që nga viti 2013 kur ju ikët nga komuna si Partia Demokratike dhe kjo ishte gjëja më e shtrenjtë që ia dhuruan Mitrovicës, andaj ju falënderoj në emër të qytetarëve për këtë mirësi", ka shkruar Bahtiri, partia e të cilit është në koalicion qeverisës me PDK-në. Ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, një ditë më parë ka përsëritur se nuk do të ketë

ndarje të Kosovës, nuk do të ketë shkëmbim të territorit dhe nuk do të ketë as autonomi për veriu. "Kjo nënkupton jo ndarje të Kosovës, jo shkëmbim territori, jo autonomi për serbët, por korrigjim të kufirit dhe njohje e anëtarësim të Kosovës në të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë. Synimi im nuk është ndryshim i kufijve, është korrigjim i tyre. Kemi 400 kilometra kufi që duhet të ndodhë si demarkim mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Thaçi. Ai ka theksuar se korrigjimi i kufijve nënkupton bashkëngjitje të plotë të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit me Republikën e

Kosovës. "Korrigjimi i kufijve nënkupton bashkëngjitjen e plotë, në tërësi të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit në Republikën e Kosovës që duhet të jetë një proces i rregullt dhe transparent e paqësor në mes të shtetit të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë ai. Presidenti Thaçi ka theksuar se kërkesa e përfaqësuesve të Luginës së Preshevës që t'i bashkohen Kosovës do të shtrohet si temë në Bruksel. "Unë do ta prezantoj në Bruksel këtë kërkesë. Kjo do të jetë e vështirë, pothuajse e pamundur. Nëse nuk do të arrijmë, do të kthehemi në pozicionet ku kemi qenë", ka thënë ai.

## Presidenti Thaçi emëron gjyqtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese

PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në mbështetje të nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit për presidentin e Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me propozimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka emëruar gjyqtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Ceremonia e betimit e gjyqtarëve të rinj para presidentit Thaçi është zhvilluar të enjten, ku e pranishme ka qenë edhe kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, Arta Rama. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Remzije Istrefi-Peci,



Radimir Leban dhe Nexhmi Rexhepi, sot kanë dhënë betimin para presidentit Thaçi. Paraprakisht këta kishin kaluar të gjitha procedurat në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe

emrat e tyre ishin shqyrtuar nga komisioni i posaçëm për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, pas zhvillimit të procedurave të

vetimit të fshehtë të mbajtura në seancat plenare të Kuvendit. Gjatë procesit të votimit të fshehtë, Remzije Istrefi-Peci kishte marrë 83 vota, Radimir Leban 71 vota, Nexhmi Rexhepi 66

vota, Safet Hoxha 62 vota dhe Bajram Latifi 58 vota. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese për herë të parë në historikun e saj tanimë është vetëm me gjyqtarë vendorë.



Flet për "Epokën e re" ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi

# Shqipëria këtë vit po

- Kjo verë ka shënuar kthesë në shumë aspekte që ishin problematike e bartur në vite sa i përket turizmit

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë, Blendi Klosi, ka thënë se vetëm në muajin korrik mbi një milion shtetas të huaj kanë hyrë në Shqipëri, duke shënuar rritje rekord prej 19-përqindësh në krahasim me korrikun e vitit 2017. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Klosi ka pohuar se këtë vit Shqipëria ka sjellë risi tek të gjitha zonat turistike. Ai ka treguar se është bërë mobilizim i madh te pikat e kalimit kufitar për t'i lehtësuar hyrjet, kurse në trafik për t'i lehtësuar lëvizjet dhe për të parandaluar aksidentet. Ndërkaq në plazhe thotë se kanë arritur një transformim radikal të situatës së sigurisë. Pavarësisht prej përmirësimeve që janë bërë në turizëm, Kolosi ka thënë se janë të vetëdijshëm se duhet bërë edhe më shumë për të arritur në nivelin maksimal të potencialit turistik që ka Shqipëria. Ai ka bërë me dije se të hyrat e siguruar nga turizmi janë rritur për 10 për qind



**EPOKA E RE**  
**Intervistoi:**  
**Sadik ZEQRIRI**

PRISHTINË, 9 GUSHT -

"Epoka e re": Ministër Klosi, jemi në sezonin e valës së turistëve dhe vizitorëve të huaj, por edhe shqiptarë në bregdetin tuaj. Sa është i përgatitur shteti shqiptar për këtë valë të turizmit?

**Blendi Klosi:** Të gjitha kapacitetet tona shtetërore janë në detyrë me angazhimin maksimal për ta siguruar mbarëvajtjen e sezonit turistik veror. Përmes Task Forcës Qendrore dhe Komiteteve Rajonale të Turizmit po punojmë në baza ditore për të garantuar siguri të përgjithshme, pastërti dhe qetësi, siguri ushqimore, shërbime shëndetësore, festa dhe mikpritje. Paralelisht, organet tati-more janë në detyrë me forca të shtuara, për ta luftuar informalitetin në këtë sektor dhe për ta kontrolluar cilësinë e shërbimeve që ofrojnë subjektet private. Trendi dyshifror i rritjes së turizmit po konfirmohet edhe këtë vit dhe ne jemi shumë të vetëdijshëm që sukcesi i industrisë së turizmit në dekadën e ardhshme varet nga aftësia jonë për t'u organizuar dhe përballuar në mënyrën sa më të suksesshme këtë fluks gjithnjë në rritje të turizmit.

"Epoka e re": Ministër, vitin 2018 e keni cilësuar viti i turizmit shqiptar. Çfarë keni ofruar më shumë sesa vitet paraprake për pushuesit në bregdet dhe turistët nëpër vendet malore turistike?

**Blendi Klosi:** Vetëm në muajin korrik 2018 mbi një milion shtetas të huaj kanë hyrë në Shqipëri, duke shënuar një rritje rekord prej 19-përqindësh në krahasim me korrikun e vitit 2017. Gjatë muajit qershor dhe korrik 2018 u realizua një rritje prej 30 përqindësh të hyrjes së shtetasve të huaj nëpërmjet Aeroportit në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Këto të dhëna konfirmojnë trendin e rritjes së turizmit shqiptar, në veçanti janë dëshmi e depërtimit të turizmit shqiptar në tregje të reja botërore, e diversifikimit të produktit dhe ofertës turistike dhe shtrirjes më të madhe të aktivitetit turistik përgjatë vitit. Në këtë të fundit, më vjen mirë të sjell këtu konstatimin e reagimit të shpejtë të operatorëve turistikë, të cilët po zhvillojnë produkte të reja turistike. Këto produkte të reja po nxjerrin në pah vlerat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Shqipërisë, bashkë me kulinarinë e pasur dhe mundësitë

për aktivitete 'outdoor'. Gjithë sa po ndodh, është reflektim i një përgatitje disamujore dhe intensive. Që në nëntor të vitit të kaluar nisëm aksionin e madh kombëtar 'Pastrojme Shqipërinë që duam', ku për gjashtë muaj punë të përditshme janë pastruar rreth 20 mijë tonë mbetje. Viti 2018 po sjell risinë e gjallërimit të të gjitha zonave turistike nga veriu në jug përmes një programi shumë të pasur festash dhe

aktivitetesh argëtuese. Kalendarin ynë i festave numëron vetëm për sezonin turistik veror rreth 500 të tilla, ndërsa deri tani janë realizuar mbi 300 të shijuara nga mijëra turistë të huaj dhe vendës. Programi ynë i ri Smile Albania është vlerë e shtuar e këtij sezoni. Punësimi i 1 000 të rinjve dhe hapja e 26 pikave informuese për mikpritjen dhe orientimin e turistëve, si dhe për ndërgjegjësimin mjedisor, po forcon imazhin

miqësor të Shqipërisë para vizitorëve.

"Epoka e re": Sa u ofron shteti shqiptar qytetarëve të huaj, por dhe vendorëve, siguri, infrastrukturë dhe ambient të pastër mjedisor?

**Blendi Klosi:** Policia e Shtetit po punon me kapacitet maksimal dhe, përveç shtimit të numrit të efektivëve, janë ngritur edhe stacione të reja policie në zona



# ofron risi në turizëm

eve dhe agjencive të specializuara po bëjnë kontrollë të rregullta dhe po aplikojnë masa radikale për ta rritur sigurinë ushqimore, parandaluar shkarkimin e ujërave në det, reduktuar nivelet e zhurmave, përmirësuar kushtet higjienë-sanitare dhe për t'i menaxhuar sa më mirë mbetjet urbane për një Shqipëri sa më të pastër. Sa i përket infrastrukturës, përveç projekteve të mëdha rrugore, portuale e aeroportuale që janë në zhvillim e sipër, këtë vit kemi zbatuar edhe programin e rehabilitimit të rrugëve ekzistuese për të ofruar siguri më të madhe dhe lëvizshmëri më të lehtë gjithë pushuesve drejt destinacioneve të tyre. Thënë të gjitha këto, nuk dua të jem jorealist. Kemi ende probleme, jo të gjitha kemi arritur t'i korrigjojmë brenda një sezoni. Jemi shumë të vetëdijshëm dhe të ndërgjegjshëm se duhet ende shumë më shumë për të mbërritur në zhvillimin e një industrie të qëndrueshme turistike. Por, kjo verë shënoi kthesën në shumë aspekte që ishin problematike e bartur në vite.

**"Epoka e re":** *Ministër, disa media po shkruajnë se shteti shqiptar nuk po ofron siguri dhe po ka edhe fryrje të çmimeve të faturave të ushqimit të taksive dhe të shërbimeve të tjera. A ka kontroll shtetëror për këto fenomene?*

**Blendi Klosi:** Me disa përjashtime shumë të vogla, media, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, ka qenë tejet profesionale në raportim dhe bashkëpunuese me ministrinë tonë për promovimin e Shqipërisë turistike, por edhe për identifikimin dhe adresimin e problematikave të caktuara. Pavarësisht prej përmirësimeve, jemi tejet të vetëdijshëm që duhet bërë edhe më shumë për të arritur në nivelin maksimal të potencialit turistik që kemi. Thashë edhe më sipër, ne kemi fituar betejën e shifrave turistike, na duhet të fokusohemi te rritja e cilësisë, ku sektori privat ka shumë për të bërë në këtë drejtim. Shqipëria turistike që duam është përgjegjësi e ndarë e të gjithëve dhe me gjithë vështirësitë e nivelit qendror dhe vendor të qeverisjes, jemi maksimalisht të angazhuar për t'i përmbushur gjithë detyrimet tona dhe në këtë drejtim kërkujmë edhe angazhim maksimal të sektorit privat për ta rritur cilësinë e shërbimeve. Turizmi është një industri shumë e ndjeshme dhe çdo lajm i keq, sado i vogël dhe i izoluar, mund të ketë efekte të gjëra dëmtoese. Për këtë arsye, ne u bëjmë apel të gjithëve të jenë të kujdesshëm në jehonën e lajmeve të tilla, në mënyrë që të mos krijohen përgjithësimet të gabuara

nga rastet individuale dhe të izoluar. Në veçanti u bëjmë thirrje të gjithëve, e sidomos pushuesve, që sa herë që ballafaqohen me parregullsi, të na njoftojnë dhe të jenë bashkëpunëtorët e agjencive dhe inspektorateve përkatëse për mënjanimin e çdo shkelje dhe parregullsie që mund të ndodhë.

**"Epoka e re":** *Qytetarët e Kosovës tradicionalisht janë pushues në bregdetin shqiptar, duke filluar pushimet që nga Shëngjini, Velipoja e deri në Saranda. Por, siç thashë dhe më parë, disa media po paraqesin aty-këtu plazhe jo të sigurta, duke kritikuar se nuk ka roje plazhi etj. A jeni marrë me këtë çështje?*

**Blendi Klosi:** E përsëris, bashkëpunimi me medien ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë i mirë dhe ne e vlerësojmë maksimalisht profesionalizmin e medias në raportimin mbi turizmin në Shqipëri. Edhe ato pak raste të raportimeve me tone më kritike, ne jemi të prirë t'i shohim si përpjekje dashamirëse për të ndikuar pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe ngritjen e standardit të përgjithshëm të turizmit në Shqipëri. Të dhënat e fundit mbi numrin e turistëve, të ardhurat nga turizmi, zgjerimi i gamës së produkteve të turizmit, shtrirja kohore dhe territoriale e turizmit tregojnë për rritje të qëndrueshme, në të njëjtën kohë janë dëshmi se edhe nëse ekzistojnë tendenca për dëmtim imazhi, ato nuk kanë funksionuar. Ne tanimë po i afrohem numrit 200 të kullave të vrojtimit që janë ngritur në gjithë vendin dhe rreth 70 për qind e tyre janë të pajisura me personel. Ky numër rritet rregullisht pasi kulla të reja ngritën çdo ditë në zonat breguore të vendit, me synimin që ta arrijmë numrin e nevojshëm për mbulueshmëri të plotë me kulla që është afërsisht 240. Sot në Shqipëri në total janë 250 vrojtues plazhi të trajnuar dhe të certifikuar. Pavarësisht se vëmendjen publike tërheqin gjithmonë rastet e fatkeqësive në plazhe, të dhënat flasin dy gjëra konkrete: një, numër të reduktuar të fatkeqësive në plazhe në krahasim me vitin paraardhës dhe dy, dhjetëra raste të shpëtimit të jetës nga vrojtuesit e plazheve dhe nga punonjësit e qendrave shëndetësore pranë stacioneve të plazhit.

**"Epoka e re":** *Ministër, pse në mediet e Kosovës nuk e promovoni Shqipërinë turistike duke u kujdesur për t'i sensibilizuar pushuesit?*

**Blendi Klosi:** Kohët e fundit kemi

parë rritje të bashkëpunimit mes operatorëve turistikë dhe kulturorë të Shqipërisë dhe Kosovës, që po konkretizohen jo vetëm me ngjarje promovuese, por edhe produkte dhe paketa të përbashkëta turistike. Një kalendar i përbashkët kulturor në mes të ministrive përkatëse të kulturës i ka dhënë një dinamikë të re shkëmbimit kulturor në mes të Shqipërisë dhe Kosovës. Një zhvillim shumë inkurajues është edhe bashkëpunimi në mes të medieve dhe shkëmbimi i produktit mediatic mbi promovimin e turizmit shqiptar. Kohët e fundit shohim edhe rritje të numrit të fotografëve dhe blogerëve shumë të suksesshëm nga Kosova, të cilët zbulojnë bukuritë e peizazhit natyror dhe kulturor të Shqipërisë dhe bëjnë një promovim shumë efektiv për publikun e Kosovës dhe më gjerë.

Ne tanimë po përgatitemi për një organizim të madh në Prishtinë ku do t'i konkretizojmë planet për rritjen e bashkëpunimit turistik në mes të Shqipërisë dhe Kosovës, duke i bërë bashkë operatorët, gazetarët, artistët, profesionistët dhe zyrtarët e institucioneve publike qendrore dhe lokale. Deri në fund të këtij viti ne do të kemi një dokument të ri strategjik mbi promovimin e turizmit shqiptar, diçka që i ka munguar turizmit tonë deri tani. Synimi ynë është që të jemi sa më të fokusuar, efektivë dhe të mençur për shpenzimin e parasë publike për promovimin turistik të vendit tonë. Pjesë e kësaj qasje të re strategjike për promovimin turistik do të jetë edhe Kosova, natyrisht, mbi të gjitha promovimi i Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe rajonit të Ballkanit Perëndimor, si destinacion i përbashkët në tregje të treta. Ne besojmë se bashkëpunimi rajonal turistik, në këtë pikë ai me Kosovën, është më kryesor për ne, dhe do të na mundësojë të jemi sa më të konkurrenshëm në një treg global turistik gjithnjë në rritje.

**"Epoka e re":** *Përpos turizmit bregdetar, Shqipëria ofron edhe turizëm malor me atraksione të ndryshme. A prisni që vit pas viti rritja e ditëve të kaluara në Shqipëri dhe rritja e parave të shpenzuara në Shqipëri të jetë më e kënaqshme?*

**Blendi Klosi:** Trend të konsiderueshëm të rritjes sivjet kemi konstatuar te vizitueshmëria e muzeve dhe monumenteve të kulturës si dhe e zonave të mbrojtura të natyrës. Numri i vizitorëve në zona të

mbrojtura të natyrës ka shënuar rritje prej 30 përqindësh në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018. Ndërsa shembulli më tipik i këtij trendi pozitiv është turizmi kulturor, pasi në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 u shënuar rritje prej 70 përqindësh në vizitueshmërinë e muzeve dhe monumenteve në krahasim me gjashtëmujorin e parë të 2017-s. Ndërsa po të krahasohet me të njëjtën periudhë të vitit 2014, rritja është në nivelin 188 për qind. Nga të dhënat e institucioneve financiare për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 kemi konfirmimin se të hyrat e siguruar nga turizmi janë rritur për rreth 10 për qind. Këto janë shifrat që i kam më përzemër, sepse është ajo çka synojmë: të mos flasim më për sezon turistik në Shqipëri, por për turizëm gjithëvjetor. Ndaj jemi duke punuar shumë fort edhe në drejtim të ngritjes së agroturizmit, me paketa lehtësuese financiare që kemi miratuar sesionin parlamentar që u mbyll, me promovimin dhe mbështetjen e këtij drejtimi të rëndësishëm turistik.

**"Epoka e re":** *Cili është bashkëpunimi i shtetit shqiptar me atë të Kosovës në fushën e turizmit. Sa po zbatohen marrëveshjet e kësaj fushe dhe cili është mesazhi juaj për pushuesit dhe vizitorët nga Kosova?*

**Blendi Klosi:** Siç e shpjegova edhe më parë, ka një dinamizim të bashkëpunimit turistik në mes të Shqipërisë dhe Kosovës dhe gjatë kësaj vjeshte do të ulemi bashkë edhe një herë për të diskutuar se si mund të rritet edhe më tej ky shkëmbim, pasi mundësitë dhe potencialet turistike në të dyja anët janë të pafundme. Pushuesit e Kosovës që vijnë në Shqipëri për turizëm për ne nuk janë vetëm pushues dhe vizitorë. Janë pjesë përbërëse e jona në kuptimin kombëtar, por në veçanti janë shtylla kurizore mbi të cilën është ndërtuar dhe zhvilluar turizmi shqiptar në gjithë këto vite. Për pushuesit nga Kosova në Shqipëri ne duam të bëjmë më të mirën që ata të vazhdojnë të ndihen si në shtëpinë e tyre, sikundër ndihemi edhe ne kur jemi në Kosovë. Kur bëhet fjalë për turizmin, ne gjithmonë kemi nxitur shprehjen e çfarëdo shqetësimi që mund të kenë gjatë qëndrimit të tyre. Nuk duhet harruar që rritja dhe zhvillimi i turizmit në Shqipëri doemos ka efekte pozitive edhe në turizmin dhe zhvillimin e përgjithshëm të Kosovës dhe anasjelltas.

me fluks më të madh turistik. Mobilizim të madh kemi edhe te pikat e kalimit kufitar për t'i lehtësuar hyrjet dhe në trafik për t'i lehtësuar lëvizjet dhe parandaluar aksidentet. Në plazhe kemi arritur një transformim radikal të situatës së sigurisë, duke ndërtuar një rrjet të tërë kullash vrojtimi dhe duke aftësuar e certifikuar një numër të madh vrojtuesish të plazhit. Në të njëjtën kohë përmes inspektorat-



## MAPL-ja nënshkruan marrëveshje me UNDP-në

PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ivan Todosijeviq, ka pritur në takim përfaqësuesen e përhershme të UNDP-së për Kosovë, Ulrika Richardson. Me këtë rast ministri Todosijeviq ka falënderuar përfaqësuesen e përhershme të UNDP-së për Kosovë, Richardson, për përkrahjen e ofruar ndër vite për MAPL-në dhe komunat me qëllim të avancimit dhe forcimit të

kapaciteteve institucionale, si dhe rritjen e transparencës në punën e tyre. Edhe përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së për Kosovë, Ulrika Richardson, ka falënderuar ministrin Todosijeviq për mikpritjen dhe bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet institucioneve të vendit dhe UNDP-së. Me pas ministri Todosijeviq dhe përfaqësuesja Richardson kanë nënshkruar marrëveshjen e

mirëkuptimit e cila siguron dhe mundëson themelimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe rritjen e transparencës për MAPL-në. Ministri Todosijeviq ka theksuar se qëllimi i MAPL-së është t'i përmirësojë kontrollin e brendshëm dhe ta rrisë transparencën me qëllim që të ndihmojë në zvogëlimin e parregullsive të brendshme, duke plotësuar rolin e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA),

forcimin e llogaridhënies, transparencës dhe efikasitetit institucional, si dhe duke frymëzuar ministrinë e tjera dhe komunat për ta ndjekur këtë shembull. "Kontrollet e brendshme nuk duhet të përdoren vetëm si mjet për parandalimin e parregullsive dhe sigurimin e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret, por ato duhet të përdoren për ta përmirësuar sistematikisht funksionimin institucional, veçanërisht në



lidhje me efikasitetin dhe efektivitetin, në anën tjetër kapacitetet dhe performancën institucionale", është shprehur Todosijeviq.

## Britania dhe Gjermania kundërshtojnë ndryshimin e kufijve

PRISHTINË, 9 GUSHT - Ambasada e Britanisë së Madhe dhe ajo e Gjermanisë në Kosovë kanë thënë se thirrjet për ndryshim të kufijve të Ballkanit mund të sjellin destabilizim. "Ne besojmë se thirrjet për modifikim të kufijve nacionalë mund të jenë destabilizuese. Ashtu siç kemi qenë gjithmonë të qartë, normalizimi i marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë është vendimtar për sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin e të dyja vendeve dhe rajonit në tërësi. Qeveria britanike beson

se kjo duhet të jetë në bazë të njohjes së vendeve të pavarura brenda kufijve të tashëm. Ne vazhdojmë ta mbështesim dialogun të lehtësuar nga Bashkimi Evropian me qëllim të gjetjes së një zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme me të cilët përfitojnë të dy vendet", ka thënë Ambasada e Britanisë në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë". Edhe Ambasada e Gjermanisë është kundër ndryshimit të kufijve. "Ministri i shtetit, Michael Roth, sikurse edhe ambasadori

Heldt në intervista të ndryshme e kanë bërë të qartë pozicionin zyrtar lidhur me dialogun për normalizim të marrëdhënieve. Me këtë, qëndrimi i Qeverisë Federale të Gjermanisë është i njohur", thuhet në një deklaratë të kësaj ambasade për "Radion Evropa e Lirë". Roth dhe Heldt kanë thënë më herët për mediet e Kosovës, se ndarja e kësaj të fundit dhe lëvizjet e kufijve janë shumë të rrezikshme dhe mund ta destabilizojnë të gjithë rajonin e Ballkanit.



## Ministrja Hoxha: Agjenda evropiane na bashkon të gjithëve



EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 9 GUSHT - Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka zhvilluar një ligjëratë me studentët e Akademisë Verore Ndërkombëtare në të cilën kanë marrë pjesë 53 studentë të ardhur nga 23 vende të botës, tema e së cilës ishte perspektiva evropiane e Kosovës. Me këtë rast ministrja Hoxha ka theksuar se stabiliteti i brendshëm, funksionimi demokratik i rendit dhe sundimit të ligjit në tërë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe avancimi i të drejtave dhe lirive për secilin qytetar është një përpjekje e përhershme e institucioneve të shtetit të Kosovës. "Në ligjëratën me

studentët e Akademisë Verore Ndërkombëtare, 53 studentë të ardhur nga 23 vende të botës, theksova rëndësinë e shpalljes së pavarësisë së vendit tonë para 10 vjetësh si dhe përparimin për këtë kohë. Integrimi i Kosovës në BE nuk ka alternativë. Agjenda evropiane bashkon të gjithë qytetarët, pavarësisht prej përkatësisë etnike, fetare apo politike. Kjo rrugë kërkon përpjekje të fortë nga ana jonë në mënyrë që t'i përshpejtojë reformat e brendshme. Republika e Kosovës është në fazën e procesit të liberalizimit të vizave me BE-në, kemi arritur t'i përmbushim të gjitha detyrimet e kërkuara nga BE-ja. Së shpejti presim të kemi lëvizje të lirë të qytetarëve tanë", ka thënë ministrja Hoxha.

## LDK-ja mbështet themelimin e kanalit televiziv për mërgatën

PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Shefi i Grupit Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka pritur në takim grupin nismëtar nga mërgata për themelimin e kanalit televiziv të mërgatës. Ai ka thënë se kjo parti mbështet themelimin e këtij kanali. "Kjo është një ide që duhet të përkrahjet. Televizioni Publik i Kosovës (RTK) duhet të ofrojë program për afër 700 mijë

qytetarë të Kosovës që jetojnë në Evropën Perëndimore dhe në Amerikë. Këta qytetarë kanë kontribuar shumë për çështjen e Kosovës. Shteti i Kosovës përmes një kanali televiziv publik për mërgatën duhet të ndihmojë gjeneratën e re të lindur në mërgatë ta mësojë gjuhën e kulturën shqipe si dhe t'i promovojë investimet e mërgatës në Kosovë", ka thënë Hoti. Ai ka

theksuar se themelimi i këtij kanali mund të ketë ndikim edhe në aspektin e investimeve. "Shumës prej rreth një miliard eurosh remitanca në vit që shkojnë për konsum të familjeve në Kosovë, përmes promovimit të mundësive për biznes në Kosovë nga ky kanal televiziv, mund t'i shtohet edhe një miliard euro remitanca për investime", është shprehur Hoti.





# Merren masa disiplinore ndaj 200 punonjësve shëndetësorë për mosrespektim të orarit të punës

Për shkak të keqpërdorimit të kartelave personale për verifikim në punë janë ndërmarrë masa disiplinore ndaj 200 punonjësve shëndetësorë (mjekë, infermierë dhe staf të administratës) në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Me këtë rast ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka paralajmëruar se me qëllim të rritjes së disiplinës në punë masa të tilla do të ndërmerren edhe në institucionet e tjera publike shëndetësore



**EPOKA ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 GUSHT - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, të enjten ka bërë me dije se janë ndërmarrë masa disiplinore për rreth 200 mjekë, infermierë dhe staf të administratës në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) për mosrespektim të orarit të punës. Ismaili ka paralajmëruar se të gjithë do të sanksionohen sipas procedurave ligjore në fuqi. Ai ka treguar se ndërmarrja e masave disiplinore ka filluar në QKUK dhe do të vazhdojë edhe në të gjitha institucionet e tjera publike shëndetësore me qëllim të rritjes së disiplinës në punë. "Së fundi, në QKUK kanë ndodhur keqpërdorime të tjera të kartelave personale për verifikimin në punë. Rreth 200 mjekë, infermierë dhe staf i administratës i

kanë keqpërdorur ato. Të gjithë do të sanksionohen sipas procedurave ligjore në fuqi. Kemi nisur me QKUK-në dhe do të vazhdojmë me të gjitha institucionet e tjera publike shëndetësore për rritjen e disiplinës në punë. Nuk do të ndalemi në misionin për përmirësimin e sektorit shëndetësor. Bashkë mund ta bëjmë këtë", ka shkruar Ismaili në llogarinë e vet në "Facebook". Sipas Ismailit, janë zhgënjyese ndonjëherë lajmet që vijnë nga spitalet tona, edhe pse bëhet fjalë për një numër të vogël, ku profesionistët shëndetësorë nuk e respektojnë orarin e tyre të punës. Ai ka rikujtuar se një nga prioritetet e tij kur ka marrë detyrën e ministrit të Shëndetësisë, përveç blerjes së pajisjeve të reja mjekësore dhe rinovimit të spitaleve e klinikave, ka qenë kthimi i dinjitetit të personelit mjekësor. "Rritjen e pagave për kujdestari

tashmë e kemi realizuar, ndërsa po punojmë intensivisht t'i arrijmë rezultatet më të mira të mundshme që në Ligjin për Paga profesionistëve tanë shëndetësorë t'u sigurojmë paga meritore. Ky mision që kemi nisur është për të gjithë, për qytetarët dhe stafin mjekësor. Prandaj, kemi nevojë edhe për bashkëpunimin e tyre", ka deklaruar Ismaili. Po gjatë kësaj jave në QKUK tre mjekë janë suspenduar dhe tre të tjerë janë dërguar në komision disiplinor për shkak se nuk kanë qenë në vendin e tyre të punës në

kohën kur drejtori i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK), Basri Sejdiu, ka bërë një inspektim në disa klinika. Si rrjedhojë, tre mjekë janë suspenduar nga puna, tre të tjerë janë dërguar në komision disiplinor, përfshirë edhe dy infermierë. Këtë sjellje, sipas ministrit Ismaili, nuk e meritojnë mijëra profesionistë shëndetësorë të cilët e bëjnë punën e tyre me nder dhe përgjegjësi, që të njollosen nga raste të tilla. Prandaj, në këto situata ai ka thënë se nuk do të ketë kompromis dhe askush nuk do të

falet. "Duke e mirëkuptuar punën e vështirë dhe lodhjen e madhe që mund ta kenë gjatë ushtrimit të profesionit, mungesa në vendin e punës nuk e arsyeton askënd. Mungesa e tyre në vendin e punës mund të jetë humbje e madhe për dikë. Ne po punojmë çdo ditë që t'i përmirësojmë kushtet për personelin mjekësor në vend, siç bëjmë ditë më parë duke rritur pagat e kujdestarëve për ta, por çdokush që sillet në mënyrë të papërgjegjshme karshi punës dhe qytetarëve tanë, nuk e meriton të jetë aty", ka thënë Ismaili.

# Kryeprokurori kërkon verifikim të çdomosveprimi para vrasjes në Gjakovë

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 GUSHT - Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka kërkuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë që urgjentisht ta fillojë grumbullimin e informatave për të verifikuar çdo mosveprim i cili mund të cilësohet si element i ndonjë veprë penale në lidhje me vrasjen e dyfishtë që ndodhi të martën në lagjen Brekoc të Komunës së Gjakovës, ku në rrethana ende të pasqaruar një 43-vjeçar ka qëlluar për vdekje bashkëshorten dhe vajzën e tij të moshës nëntëvjeçare. Lumezi ka bërë me dije se nëse konstatohen veprimet e tilla, të nxirret menjëherë aktvendimi për fillimin e hetimeve kundër çdo personi të përfshirë në kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve, për të cilat ka qenë i obliguar t'i ndërmarrë, të cilat ndërliken me kërcënimet ndaj gruas dhe vajzës së vrarë në lagjen Brekoc të Komunës të



Gjakovës.

Po në lidhje me këtë rast kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka takuar të enjten ministrin e Drejtësisë, Abelard Tahiri, atë të Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi dhe drejtorin e Departamentit për Operacione në Policinë e Kosovës, Rashit Qalaj. Në këtë takim drejtuesit e institucioneve të rendit dhe ligjit kanë shprehur shqetësimet e tyre të thella për ngjarjen dhe janë zotuar për të bërë një hetim të plotë për

rrjedhën e trajtimit të këtij rasti nga organet e rendit.

Po gjatë këtij takimi palët kanë shprehur gatishmërinë e plotë që në rast të evidentimit të neglizhencës eventuale nga secili person zyrtar i ngarkuar për t'i parandaluar rrethanat e kësaj ngjarjeje, do të kërkohet llogaridhënie dhe personat zyrtarë përgjegjës do të dalin para përgjegjësisë. "Institucionet e rendit dhe ligjit vlerësojnë se ky akt tragjik është momenti i fundit i reflektimit për një trajtim

shumë serioz të politikës shtetërore, e cila është në funksion të mbrojtjes dhe sigurisë së jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovë nga çdo cenim i mundshëm. Krerët e institucioneve të rendit dhe ligjit inkurajojnë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe institucionet, të cilat kanë përgjegjësi në këtë fushë, për të bashkëpunuar ngushtësisht për parandalimin efikas të çdo cenimi të jetës që mund t'u kanoset qytetarëve të Kosovës, pa dallim", është thënë në njoftimin e institucionit të Prokurorit të Shtetit.

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ka filluar hetimet ndaj policëve për të parë nëse ka pasur lëshime në rastin e vrasjes së dyfishtë që ka ndodhur ditën e martë. "Inspektorati Policor i Kosovës më datë 8. 8. 2018, sipas detyrës zyrtare, ka filluar hetimin preliminar ndaj disa zyrtarëve policorë të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Gjakovë lidhur me dyshimet për

neglizhencë dhe moskryerje të detyrave", është thënë në një komunikatë të IPK-së.

Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj) në zyrën e kryeministrit ka dënuar vrasjen e dyfishtë që ka ndodhur në Gjakovë ditën e martë. Kjo agjenci ka kërkuar vëmendjen e shtuar nga institucionet e edukimit, sigurisë dhe drejtësisë, për t'i mbrojtur jetët e grave dhe të vajzave. "ABGj kërkon që forca e ligjit, shtetit të së drejtës, të veprojnë ndaj përgjegjësit me dënim maksimal, si dhe të ndërmarrë masa ndaj të gjithë atyre personave kompetentë nëse nuk kanë reaguar sipas protokolleve shtetërore për parandalimin e rastit të dhunës në familje. Jeta e humbur e çdo gruaje, vajze, është humbje për shoqërinë, kapitalin njerëzor dhe të ardhmen e vendit. Është rrezikim i drejtpërdrejtë i sundimit të rendit dhe ligjit të shtetit të cilin me shumë sakrificë po e ndërtojmë", është theksuar në këtë reagim të ABGj-së.



# Kombet e vogla, figura të mëdha



Shkruan: Agron HOTI

Perspektiva e kombeve ndërtohet dhe nuk trashëgohet. Kjo bëhet me përpjekje të vazhdueshme, produktivitet dhe arritje që shënojnë kombet në zhvillimin dhe konsolidimin e tyre. Sigurisht se ky proces është evoluiv, gjithnjë duke u bazuar në rrethanat, mjedisin dhe kohën në të cilën jetojnë dhe veprojnë kombet.

Lindja, ndërtimi dhe zhvillimi i kombeve jo gjithmonë është bërë në baza të shëndosha, shpesh nëse jo gjithmonë është bërë kurriz dhe dëm të tjetrit. Varësisht nga zhvillimi i gjithëmbarshtëm i një kombi rritet dhe konkurrueshmëria e tij në të gjitha zhvillimet e mundshme ashtu sikundër që avancohet pozita ndërkombe-tare e tij.

Kombet e zhvilluara konkurrancën e tyre e mbështesin në potencialin dhe kapacitetet ekonomike, e sidomos ato industriale, për inovacion dhe avancim teknologjik. Mbi këtë bazë kombet e zhvilluara gjenerojnë aq shumë figura të njohura publike saqë është e vështirë të dallohet më e rëndësishmja ndër më të rëndësishmet.

Aq inovative janë bërë ekonomitë e zhvilluara në glob saqë e kanë bërë të pamundur dallimin se kush është më i vlershëm në një shoqëri e kush më pak. Kjo tashmë është bërë modë e traditë sa askush s'qanë kokën se kush është më i rëndësishmi.

Nëse deri dje gjiganti i ShBA-së, General Motors, kishte qarkullimin më të madh financiar në ShBA, ndoshta edhe në botë, sot kjo ka ndryshuar, sepse janë Apel, Microsoft, Google, Facebook etj. ato që prijnë. Nëpër vendet e zhvilluara, figura të shumta të sektorit privat në një masë janë më të pranishme, më të dukshme dhe më atraktive në media dhe në jetën publike sesa në sektorin publik. Por, nuk duhet harruar që në vendet e zhvilluara sektori publik prodhon po aq shumë figura të ndryshme publike saqë është e vështirë të thuash se cili ka arritur më shumë e cili më pak.

Pra, me një fjalë kombet e zhvil-

luara janë koherente dhe kohezive sa i përket gjenerimit të figurave të shumta publike me ndikim në fusha të ndryshme të zhvillimit kombëtar, rajonal dhe global, kjo sepse është zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik që mundëson një gjë të tillë duke krijuar elita dhe nivele të larta emancipative që drejtojnë shoqëritë.

Ndërkohë që, potenciali i kombeve të vogla, dhe sidomos atyre të varfra e në zhvillim, është tepër i ngushtë për të prodhuar shumë figura të mëdha, sepse vetë organika e kombeve të vogla është e tillë sa nuk ka mundësi të japë shumë figura publike me ndikim global në fusha të ndryshme.

Pastaj, ka një dallim në gjenerimin e figurave publike me ndikim në botë mes kombeve të zhvilluara dhe atyre të varfra dhe në zhvillim. Përderisa kombet e zhvilluara prodhojnë figura publike të të gjitha drejtimeve zhvillimore, kombet e varfra dhe në zhvillim nuk e kanë këtë kapacitet. Përderisa në ekonomitë e zhvilluara flitet për projeksione zhvillimore globale, në ekonomitë e varfra dhe në zhvillim ende dominon logjika e heronjve. Mbi këtë kuadër lindin edhe figurat e ndryshme publike.

Kombi shqiptar hyn në grupin e kombeve të vogla që sapo ka hyrë në grupin e kombeve në zhvillim. Shikuar rrethanat historike të lindjes, zhvillimit dhe konsolidimit të kombit shqiptar, të jep të kuptosh mundësinë dhe kapacitetet e kufizuara të këtij kombi për të prodhuar figura publike me ndikim në botë. Sigurisht që kombit shqiptar nuk i mungojnë figura të shquara me nam botëror, por vetë rrethanat historike dhe vetë organika e një kombi të vogël, siç jemi ne, nuk ka mundësi të gjenerojë më shumë.

Pa dashur t'i hyj në hak asnjë figure publike shqiptare me nam në botë, në këtë shkrim dua t'i referohem figurës së Adem Demaçit, i cili gjysmën e jetës e kaloi në burgjet rënda jugosllave duke mbrojtur kauzën e drejtë të kombit shqiptar, pra për të qenë i barabartë mes të barabartëve në Evropë. Figura e Adem Demaçit është rast unike në Evropë, ashtu siç ishte në Afrikë të Jugut Nelson Mandela.

Kontributi i Adem Demaçit për ndërtimin dhe avancimin e të drejtave të kombit shqiptar në Evropë pati jehonë nëpër qarqe të ndryshme evropiane dhe në botë. Ky kontribut i tij ishte në

linjë me përpjekjet e pashembullta shqiptare për evropizmin e Ballkanit dhe Evropës në tërësi. Ky kontribut ishte në linjë me përpjekjet e kombeve të tjera për barazi dhe drejtësi brenda kontinentit të Evropës.

Sikur kombi shqiptar ta kishte të përfunduar konsolidimin e tij, siç e patën përfunduar konsolidimin e tyre kombe të tjera para prej së paku 100 vjetësh, sigurisht se figurat publike që do të prodhohin sot si komb do të ishin nga fusha prej më të ndryshmeve e jo vetëm nga perspektiva e heroizmit shqiptar. Por, ashtu siç e thashë më lart, janë rrethanat ato që orientojnë gjenerimin e figurave të njohura publike jo vetëm të kombit shqiptar, por edhe të kombeve të tjera.

Prandaj, figura e Adem Demaçit me të drejtë e meriton të quhet jo Mandela i Evropës, por Ademi i Evropës, sepse rrethanat në të cilat gjendej dhe gjendet kombi shqiptar ishin të tjera me ato të Afrikës Jugore. Pikërisht pse kontributi i Adem Demaçit ishte

rast unik në Evropë, Parlamenti Evropian më 4 dhjetor 1991 i pati dhënë çmimin "Sakharov" për mendim të lirë, në cilësinë e kryetarit të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kosovë.

Prandaj, kombi shqiptar ka ditur të respektojë dhe do t'i respektojë figurat e shquara publike, sepse si komb i vogël nuk ka potencial të prodhojë shpesh figura të shquara me nam botëror. Ndërkohë që ShBA-ja, Japonia, Gjermania, Britania e Madhe etj., janë gjendje që çdo ditë të prodhojnë nga një figurë publike me nam botëror. Diskursi ynë duhet të jetë në favor të figurave të pakta publike komb-ndërtuese dhe komb-zhvilluese që mund të prodhojmë, e jo në favor të degjenerimit të tyre për interesa të ngushta, sepse veprime të tilla dekadente zbehin vlerat tona si komb dhe për më tepër na çorientojnë.

Avancimi i pozitës së shqiptarëve në rajonin tonë të dalë nga kllapia, edhe pse të ndarë në disa shtete, ka filluar t'i rrisë

kapacitetet gjeneruese të prodhimit të figurave të shquara publike me nam botëror. Zhvillime të tilla sigurisht se do ta rrisin aftësinë konkurruese të kombit shqiptar përballë kombeve të tjera dhe kjo sigurisht se do të ketë efekte pozitive jo vetëm brenda kombit shqiptar, por edhe përtej. Shqiptarët, me aq sa kanë pasur potencial e mundësi dhe për aq sa kanë lejuar rrethanat, kanë kontribuar për të mirën e rajonit, Evropës dhe njerëzimit në përgjithësi. Për fatin tonë të mirë, ende vazhdojmë të jemi gjenerozë dhe kjo na bën të barabartë mes të barabartëve. Adem Demaçi është shembulli më tipik dhe vlera më sublime shqiptare për të mirën e së ardhmes së kombit shqiptar në veçanti dhe Evropës në përgjithësi. Ai komb që vlerëson vetveten di të vlerësojë edhe tjetrin, e duke vlerësuar vetveten dhe tjetrin, kontribuohet në zhvillimin dhe avancimin e parimeve universale për të drejtat e njerëzimit në përgjithësi.





# Pushkollli: Dëmet nga automjetet e pasiguruara kapin shifrën mbi 27 milionë euro

Drejtori ekzekutiv i Byrosë Kosovare të Sigurimeve (BKS), Blerim Pushkollli, ka thënë se numri i veturave të pasiguruara në trafik është në mes 35 mijë deri në 50 mijë. Sipas tij, i gjithë ky numër ka shkaktuar dëme si për shtetin, po ashtu dhe për fondin e sigurimit në vlerë prej 27 milionë eurosh gjë që, sipas tij, është pengesë edhe për anëtarësimin e byrosë në instanca ndërkombëtare



Austri e cila ka kundërshtuar që ky shtet ta mbulojë Kosovën me karton të gjelbër", ka deklaruar ai.

Pushkollli ka thënë se BKS-ja është duke operuar me humbje për shkak të dëmeve të mëdha që duhet të paguhet nga Fondi i Kompensimit për automjetet e pasiguruara. "Për periudhën janar-qershor të këtij viti të hyrat nga primet e sigurimeve ishin 2.4 milionë euro, pagesat 2.7 milionë euro, kurse shpenzimet mbi 916 mijë euro", është shprehur

ai. Drejtori ekzekutiv i Byrosë Kosovare të Sigurimit ka bërë me dije se janë të obliguar që në 14 pika kufitare të shesin polica kufitare dhe, sipas tij, nëse asnjë automjet nuk e përmbush këtë detyrim, nuk mund të hyjë në territorin e Kosovës. Sa i përket kartonit të gjelbër si lehtësi për këtë policë, ai ka theksuar se nga 19 maji i këtij viti kjo policë mund të blihet online.

Pushkollli ka mohuar që kolonat e gjata po krijohen në kufi nga

mërgimtarët për shkak të blerjes së policës në kufi. Në pyetjen pse sistemi online nuk po ndikon në uljen e kolonave në kufi, Pushkollli ka deklaruar se nuk ka pasur mjaftueshëm kampanja për informim të mërgimtarëve. Gjatë kësaj konference Pushkollli ka folur për ndryshimin e Ligjit për importim të veturave më të vjetra se dhjetë vjet. Ai ka thënë se automjetet e vjetra paraqesin rrezikshmëri në komunikacion dhe nuk të jenë pro lejimit të tyre.

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 9 GUSHT** - Drejtori ekzekutiv i Byrosë Kosovare të Sigurimeve (BKS), Blerim Pushkollli, ka mbajtur të enjten konferencë për medie, në të cilën ka diskutuar për sfidat me të cilat përballet Kosova për anëtarësim në Byronë Ndërkombëtare të Sigurimeve, si dhe sfidat me të cilat përballet BKS-ja, ku një ndër sfidat është edhe automjetet e paregjistruara. Pushkollli ka bërë me dije se numri i veturave të pasiguruara në trafik është në mes 35 mijë deri në 50 mijë. Sipas tij, numri kaq i lartë i automjeteve të paregjistruara është për shkak të kushtëzimeve që po u bëhen qytetarëve të Kosovës, duke i detyruar t'i paguajnë shpenzimet komunale,

si ujë dhe mbeturinat. Gjithashtu, ai ka theksuar se kjo po ndodh edhe për shkak të moszbatimit të Ligjit për konfiskim të automjetit të paregjistruar. "Automjetet e pasiguruara shkaktojnë rreziqe në komunikacion dhe me këtë dëmtohet edhe buxheti. Dëmi që paguhet nga Fondi i Kompensimit është tejet i madh dhe nga viti 2010 ky dëm kap shifrën e mbi 27 milionë eurove", ka deklaruar ai. Kurse sa i përket Kartonit të Gjelbër, Pushkollli ka pohuar se janë plotësuar kushtet nga kompanitë e sigurimit, mirëpo kushti kryesor është anëtarësimi i Kosovës në OKB.

Po sipas tij, pengesë tjetër është edhe numri i madh i veturave të paregjistruara në Kosovë. "Së fundi kemi marrë një përgjigje nga Shoqata e Automjeteve në

## Posta promovon dy pulla postare me imazhet e eprorëve të UÇK-së



**PRISHTINË, 9 GUSHT (ER)** - Në 20-vjetorin e rënies së dy prej eprorëve më të shquar të UÇK-së, Bekim Berisha dhe Bedri Shala, Posta e Kosovës ka promovuar dy pulla postare me imazhet e tyre. Kryeshefi i postës, Sejdi Hoxha, u shpreh krenar për promovimin e dy pullave postare për këta dy

heronj të kombit dhe tha se me këto pulla postare po rritet edhe vlera e Postës së Kosovës. "Jemi krenarë që po promovojmë dy pulla postare shumë të çmueshme për dy heronjtë e kombit, Bekim Berisha-Abeja dhe Bedri Shala. Me rastin e 20-vjetorit të rënies po shprehim respekt, po

nderojmë familjarët, njëkohësisht po rritet vlera e filatelisë së Postës së Kosovës. Bekim Berisha dhe Bedri Shala ishin dy prej eprorëve më të shquar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", ka deklaruar Hoxha, duke shtuar se shtëpitë e këtyre dëshmorëve ishin çerdhe e UÇK-së.

## ATK-ja ka tërhequr fituesit e kuponëve fiskalë

**PRISHTINË, 9 GUSHT (ER)** - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka bërë të enjten tërheqjen e numrave potencialë fitues për rimbursim të qytetarëve nga grumbullimi i kuponëve fiskalë për periudhën e TM2 2018. Tërheqja e numrave potencialë fitues është transmetuar drejtpërdrejt në "RTK", ku janë tërhequr katër numra potencialë fitues, ashtu siç është e specifikuar në Udhëzimin Administrativ 01/2017. Numri i qytetarëve potencialë të cilët kanë fituar

për këtë periudhë është 1 540. "Qytetarët të cilët kanë numrin potencial fitues të përzgjedhur nga tërheqja, plikon me kuponë fiskalë së bashku me të dhënat e aplikimit, duhet ta dorëzojnë fizikisht të mbyllur në njërin nga drejtoritë regjionale të ATK-së, brenda afatit prej pesë (5) ditë pune pas publikimit të listës në uebfaqe të ATK-së. Dorëzimi i pikëve duhet të bëhet nga data 13 gusht deri më 17 gusht nga ora 8:00-16:00", është thënë në njoftimin e ATK-së.





## Vitin e ardhshëm pensionimi i parakohshëm i policëve

GJILAN, 9 GUSHT (ER) - Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, ka vizituar të enjten policinë rajonale të Gjilanit, ku është pritur nga drejtoresha e këtij rajoni, Elmina Mahmuti dhe bashkëpunëtorët e saj. Në këtë takim u bisedua për Ligjin e policisë, për pensionim të parakohshëm, për objektin e policisë së këtij

rajoni i cili ende nuk ka përfunduar, për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionin, për luftimin e trafikimit të narkotikëve si dhe për problemet me trafikun në nivel të regionit të Gjilanit. Me këtë rast zëvendësministri Zeka ka theksuar se MPB-ja do të përpiqet që vitin e ardhshëm ta fusë në buxhet Ligjin për pen-

sionimin e parakohshëm të policisë si dhe objektin e papërfunduar të Policisë në Gjilan. Gjithashtu, ka theksuar se MPB-ja do të jetë e pakompromis në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Vendimet e fundit të MPB-së sa i përket trafikut në nivel të Kosovës u vlerësuan se kanë sjellë rezultate të prekshme edhe në nivele të rajoneve.



## Gashi e Lushtaku diskutojnë për rehabilitimin e kanalit të Ibër Lepencit

OBILIQ, 9 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ka pritur të enjten në takim kryeshefin ekzekutiv të "Ibër Lepenc"-it, Berat Lushtaku, drejtorin teknik Demë Abazi, koordinatoren Shemsi Kelmendi dhe konsulentin për çështje mjedisore Pëllumb Gjinolli. Temë e takimit ishte prezantimi i projektit për rehabilitimin e kanalit të Ibër Lepencit, projekt ky i financuar nga kredia e Bankës

Botërore.

Ky projekt synon që me anë të rehabilitimit të kanalit ekzistues të ulen humbjet e ujit, të parandalohen derdhjet e ujërave të zeza në kanal e shumë të tjera. Po ashtu, u pajtuan që mes komunës dhe Ibër Lepencit të ketë një përfaqësues të mjedisit nga komuna, që për të gjitha zhvillimet në këtë fushë qytetarët ta kenë adresën e ankesave dhe shqetësimeve të tyre.



## Shtërpca përfiton projekt në vlerë 1.2 milion euro nga Ministria e Infrastrukturës



Prishtinë, 9 gusht (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka pritur në një takim bashkëpunimi kryetarin e Shtërpçës, Bratislav Nikoliqi, të cilin e ka njoftuar se tashmë është nënshkruar kontrata për mbështetje të projektit për rregullimin e infrastrukturës së

Shtërpçës. Ky projekt mbështetës nga Ministria e Infrastrukturës në Komunën e Shtërpçës kap vlerën prej 1.2 milion eurosh dhe përfshinë ujësjellësin, kanalizimin, si dhe ndriçimin publik, duke filluar nga Brezovica deri në Qendrën e Skijimit, përfshirë edhe tërë

"weekend zonën".

Ministri Lekaj ka thënë se mbetet i përkushtuar t'i mbështesë komunat në modernizimin dhe transformimin e infrastrukturës dhe se kjo praktikë e investimeve është bërë tashmë standard dhe kështu do të vazhdohet.

## Osman Krasniqi nga AKR-ja i bashkohet Lëvizjes Vetëvendosje

Prizren, 9 gusht (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije se subjektit që drejton i është bashkuar Osman Krasniqi, i cili vjen nga Prizreni dhe që deri më tani ka qenë pjesë e AKR-së. "Me kryetarin e Prizrenit, Mytahir Haskukën, në një takim të përzemërt mirëpritëm z. Krasniqin në subjektin tonë. Si inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës, qytetar aktiv i Prizrenit, punëtor i ditur e i devotshëm kudo e kurdo, z.

Krasniqi është përforcim për organizatën tonë dhe rritje për Lëvizjen tonë drejt sfidave të së ardhmes", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka shtuar se në zgjedhjet e fundit lokale Osman Krasniqi ishte kandidat i AKR-së për kryetar të Komunës së Prizrenit. "Përkrahja dhe ndihma e tij në balotazh ishin tejet të vlefshme për fitoren e shkëlqyeshme që i hapi rrugë ndryshimit të madh në Prizren", ka thënë Kurti.



## "Qatar Charity" vazhdon ta mbështesë Komunën e Mitrovicës

MITROVICË, 9 GUSHT (ER) - Komuna e Mitrovicës dhe organizata "Qatar Charity" me seli në Prishtinë kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për ndihmë fëmijëve jetimë në Komunën e Mitrovicës. Memorandumin e kanë nënshkruar në emër të komunës Agim Bahtiri dhe në

emër të "Qatar Charity" drejtori Mahmoud Shaker. Në ceremoninë e nënshkrimit të memorandumit ishte e pranishme edhe drejtoresha për Integritet Evropian dhe Mirëqenie Sociale, Nazan Kërveshi.

Qëllimi i nënshkrimit të memorandumit është përmirësimi i

gjendjes ekonomike të fëmijëve pa njërin apo të dy prindërit, të moshës nën 12 vjeç. Organizata "Qatar Charity" do ta sigurojë mbështetjen materiale për fëmijët që i takojnë kësaj kategorie, ndërsa që komuna është e obliguar ta hartojë listën e fëmijëve dhe ta ofrojë tërë mbështetjen tjetër për realizimin e memorandumit.





# BASHKIMI I LUGINËS SË PRESHEVËS ME KOSOVËN, ÇËSHTJE QË OBLIGON TË GJITHË, PA PËRJASHTIM

Dikujt Lugina e Preshevës mund t'i duket e vogël dhe e parëndësishme, dikush përpiket ta paraqesë si "gogol" për t'i frikësuar të tjerët, e dikush e pësjellon gjithë këtë temë me spekulime nga më të ndryshmet për interesa klanore politike. Përtej këtyre tezave qëndron Lugina e Preshevës si pjesë e pashkëputur gjeografike dhe demografike e Kosovës, por akoma e paçliruar, pa perspektivë, e privuar nga të drejtat elementare njerëzore dhe nën kërcënimin e vazhdueshëm të sigurisë



**Shkruan: Shaqir SHAQIRI**

Ideja e bashkimit të Luginës së Preshevës me Kosovën është ide dhe angazhim që bartet brez pas brezi, ku preshevarët (preshevarë, bujanocali dhe medvegjali) që nga Lidhja e Prizrenit, kryengritja e madhe kundër Perandorisë Osmane, luftës kaçake kundër mbretërisë serbo-kroato-slllovene, luftës kundër çetnikëve serbë, organizimit politik ilegal dhe legal pas LDB-së, luftës së UÇK-së dhe, së fundi, edhe luftës së UÇPMB-së u përpoqën dhe luftuan për liri dhe bashkim kombëtar. Prandaj, deklarimin e presidentit të Kosovës duhet ta kuptojmë si obligim institucional që ka Kosova karshi shqiptarëve të Luginës së Preshevës dhe territorit të saj në tërësi dhe si gatishmëri për t'u përballur institucionalisht me këtë problematikë.

Deklarimin e presidentit të Kosovës, z. Thaçi, për "korrigjimin e kufirit", duke e plotësuar pastaj se "nuk ka ndarje të

Kosovës, nuk ka shkëmbim të territoreve, por Lugina e Preshevës do t'i bashkëngjitet Kosovës", dhe duke qenë korrekt ai thotë se: "Kuptohet nëse arrihet pajtueshmëri", para se të ngriheshin zëra për dhe kundër, kjo çështje do të duhej të trajtohet për nga qasja. Pra, si do t'i qaset z. Thaçi këtij problemi? Përndryshe, deklarimin e kësaj ideje duhet ta kuptojmë si gatishmëri institucionale dhe shtetërore për të marrë përsipër angazhime absolutisht sfiduese jo sa për të bërë një korrigjim të kufirit, por për të mundësuar që shqiptarët e Luginës së Preshevës t'i bashkohen trungut kombëtar nga i cili u ndanë padrejtësisht dhe pa vullnetin e tyre. Dikujt Lugina e Preshevës mund t'i duket e vogël dhe e parëndësishme, dikush përpiket ta paraqesë si "gogol" për t'i frikësuar të tjerët, e dikush e pësjellon gjithë këtë temë me spekulime nga më të ndryshmet për interesa klanore politike. Përtej këtyre tezave qëndron Lugina e Preshevës si pjesë e pashkëputur gjeografike dhe demografike e Kosovës, por akoma e paçliruar, pa perspektivë, e privuar nga të drejtat elementare njerëzore dhe nën kërcënimin e vazhdueshëm të sigurisë.

Të mos harrojmë se preshevarët

bashkë me kosovarët ishin në demonstrata të 1968-s, në demonstrata të 1981-s, në themelimin e UÇK-së dhe në luftën e lavdishme të saj. Të mos harrojmë se sot preshevarët bartin pasojat e burgut për "Kosovën Republikë", preshevarët në trupin e tyre sot bartin plagët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Por, bartësit e institucioneve të Republikës së Kosovës le të kenë në mendje turpin dhe padrejtësinë që sot po bëhet kundrejt tyre, shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Institucionet dhe ligjet e Kosovës janë po aq përjashtues sa më vjen vështirë t'i njëjtësoj me ato të Serbisë. Preshevarët, edhe pse u dërgjën burgjeve për Kosovën Republikë, edhe pse bartin plagët e luftës së UÇK-së për liri, ata nuk gëzojnë të drejtën e dyshtetësisë dhe të pajisjes me shtetësinë e Kosovës. Edhe më keq, shumë të dëbuar nga Serbia e që kanë

gjetur strehë në Kosovë, kanë mbetur pa asnjë lloj dokumenti identifikimi. Serbia i ka shlyer nga sistemi i regjistrimit, ndërsa Kosova ligjërisht ironizon me fatin e tyre (për mos me thënë luan topa me ta).

Prandaj, ideja për të shtruar në tavolinën e bisedimeve çështjen e pazgjidhur të Luginës së Preshevës, së pari duhet të ketë një qasje shumë serioze dhe të përkrahet pa rezervë nga spektri politik kosovar dhe shqiptar në përgjithësi. Në veçanti, por jo vetëm deklarativisht, duhet të përkrahet nga spektri politik shqiptar i Luginës së Preshevës, të cilët, para se gjithash, duhet t'i bëjnë gati argumentet se pse duhet të shtrohet çështja e Luginës së Preshevës në tavolinën e bisedimeve dhe pse duhet të bëhet bashkimi i saj me Kosovën.

Pra, ne jemi të vetëdijshëm se z. Thaçi, edhe nga pozita e presidentit dhe kryenegociatorit

eventual, nuk mund i vetëm ta bashkojë Luginën e Preshevës me Kosovën, sepse ky nuk është problem që mund të zgjidhet njëanshëm. Ky problem kërkon angazhim serioz, argumente serioze, unitet serioz dhe krejt në fund qasje serioze dhe të vendosur të spektrit politik shqiptar, me qëllim që palët në tavolinë të binden se një vendim i tillë i shërben stabilitetit, paqes dhe bashkëpunimit në rend të parë të këtyre shteteve dhe se merret mbi një vendim plebishitar të shprehur nga shqiptarët e Luginës së Preshevës në mars të vitit 1992.

Deklarimi për "korrigjim të kufirit dhe që Lugina e Preshevës do t'i bashkëngjitet Kosovës", sigurisht se ngre shumë dilema, por ideja për të dialoguar për çështjen e Luginës së Preshevës nuk është në kundërshtim me asnjë normë ndërkombëtare, nuk është në kundërshtim as me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk është në kundërshtim as me idealin e luftës së shenjtë të UÇK-së. Ç'të keqe ka nëse dialogohet për çështjen e pazgjidhur të Luginës së Preshevës dhe të kërkohet bashkimi i saj me Kosovën? Ç'të keqe ka nëse për këtë arrihet pajtueshmëri e palëve dialoguese dhe diçka e tillë vërtet ndodh (edhe pse unë dyshoj)? Unë besoj se po të ndodhte diçka e tillë, ligjëvënësit kosovarë nuk e kanë të vështirë të ndryshojnë Kushtetutën dhe për të ngërthyer brenda saj edhe Luginën e Preshevës. Do të ishte shumë e dhimbshme nëse ligjëvënësit e Kosovës do të jenë të detyruar ta ndryshojnë Kushtetutën, dhe brenda atij ndryshimi të mos jetë e përfshirë Lugina e Preshevës.

**(Autori është ish i burgosur politik, ish-drejtuës lokal i UÇK-së, nënkryetar dhe zëdhënës i ish-KPPMB-së)**



## DISA MËSIMET PËR DIALOGUN



**Shkruan: Valon MURTEZAJ**

Ajnshtajni e ka shikuar orën dhe ka pyetur: Si e dimë sa është ora?

Kur është fjala për dialogun (që, në fakt, është negociim klasik), nuk është befusuese, për fat të

keq, që ende institucionet tona kanë sjellje reaktive ndaj pozicioneve të palës tjetër. Pas kaq viteve shtet, dhe sidomos pas aq dekadave vuajtjesh, do të duhej të ndodhte e kundërta. Pra, do të duhej të ishte e pranishme aftësia e gjenerimit të opsioneve paraprirëse të proceseve në çfarëdo tavoline të bisedimeve. Kjo nuk po bëhet ende, dhe nëse ndonjëherë bëhet, ajo bëhet në mënyrë të atypëratyshme, që nënkupton pa përgatitjet e duhura shumë të nevojshme.

Në vend se institucionet e Kosovës të koncentrohen për ta

përdorur strategjinë destruktive të Qeverisë së Serbisë, kundër aspiratave destruktive të tyre, shpesh ngjan e kundërta. Në këtë moment shumë delikat, të gjithë në Kosovë duhet ta ndërtojnë një kod të përbashkët të sjelljes në raport me dialogun. Gjëja e parë që duhet të bëhet është: Të dimë çfarë duam! Pra, të jemi në gjendje t'i japim përgjigjen e duhur pyetjes esenciale: Çfarë duam ne në këtë dialog? Kjo ka të bëjë me vlera terminale të Kosovës dhe popullit të saj, që do të thotë, të dimë cilat janë gjërat më të

rëndësishme për shtetin e Kosovës, dhe qytetarin e saj, që duhet nxjerrë nga ky dialog. Shpesh njerëzit që janë të përfshirë në negociata mendojnë se oferta që ofrojnë ata është e vetmja. E vërteta është se kjo nuk është ashtu. Ka edhe të tjera opsione që mund të jenë zgjidhje të përshtatshme, apo thënë me terma të tjerë, opsionet mund të përdoren në mënyra të ndryshme. Po ashtu, duhet ditur se udhëheqja dhe menaxhimi i procesit negociator nuk është të manipuluarit e të tjerëve për të bërë diçka që nuk

duhet bërë, apo që të tjerët nuk dëshirojnë ta bëjnë. E njëjta vlen edhe për menaxhimin e ekipit tënd negociator. Këtu kërkohet klimë besimi, ekspertizë reale dhe lidhshmëri me shpirt skuadre.

Ashtu siç njerëzit përgatiten kur duan të shkojnë në luftë, apo kur duan të shkojnë në dasmë, njëjtë është edhe kur duan të hyjnë në një proces negociator: duhet përgatitur mirë. Sekretet e suksesit në negociim qëndron në përgatitjen paraprake. Ora është pesë në dymbëdhjetë.



## Kryeministri i Pakistanit kërkon marrëdhënie më të mira me ShBA-në



ISLAMABAD, 9 GUSHT - Kryeministri në ardhje i Pakistanit, Imran Kahn, ka bërë thirrje për lidhje më të besueshme me Shtetet e Bashkuara, të cilat janë tensionuar pas akuzave amerikane, se Pakistani është duke iu ndihmuar kryengritësve islamikë të kryejnë luftë në Afganistan. Islamabadi në anën tjetër mohon çdo përfshirje. Khan, që pritet të betohet si kryeministër javën tjetër, është

takuar të mërkurën me ambasadorin amerikan në Pakistan, John F. Hoover, për të diskutuar uljet dhe ngritjet në marrëdhëniet në mes të dy vendeve. Muaj më parë Uashingtoni ka pezulluar ndihmën dhe asistencën ushtarake në Pakistan. "Partia ime kërkon të ndërtojë marrëdhënie të mira me Shtetet e Bashkuara duke u bazuar në respekt të dyanshëm andaj Qeveria jonë do të bashkëpunojë me ShBA-në për ta bërë këtë


marrëdhënie më të balancuar dhe më të besueshme", ka njoftuar përmes një deklaratë partia Tehreek-e-Insaf (PTI), duke ia atribuar komentet Khanit. Khan ka shtuar se ekziston një nevojë për t'i "transformuar" lidhjet diplomatike në mes të dy vendeve. Në muajin janar, presidenti amerikan Donald Trump ka ashpërsuar tonet kundër Pakistanit, duke e akuzuar këtë vend se po luan "lojë të dyfishtë" në luftimin e terrorizmit.

## ShBA-ja sërish i vë sanksione Rusisë

Sanksionet hyjnë në fuqi më 22 gusht dhe përgjithësisht kanë të bëjnë me licencat amerikane për eksportimin në Rusi të mallrave të tilla sensitive për sigurinë kombëtare siç janë pajisjet elektronike

UASHINGTON, 9 GUSHT - Departamenti Amerikan i Shtetit i njoftoi sanksione të reja të mërkurën, duke thënë se Rusia shkeli ligjin ndërkombëtar duke përdorur një agjent nervor vdekjeprurës kundër shtetasve të vet. Sanksionet hyjnë në fuqi më 22 gusht dhe përgjithësisht kanë të bëjnë me licencat amerikane për eksportimin në Rusi të mallrave të tilla sensitive për sigurinë kombëtare siç janë pajisjet elektronike.

Por Rusia tha të enjten se sanksionet e reja të Shteteve të Bashkuara në lidhje me helmimin e një ish-agjenti rus dhe vajzës së tij në Britani janë të paligjshme dhe se Rusia nuk ka të bëjë me incidentin e muajit mars. Ndërkohë Moskë është gati të reagojë, duke marrë "masa në përgjigje të këtij hapi të pamenduar mirë nga Uashingtoni". Kështu u shpreh të enjten zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme, Maria Zakharova, duke iu referuar sanksioneve ndërkombëtare. Zakharova i ka cilësuar akuzat ndaj Moskës, "thjesht cinike". Sergei Skripal dhe vajza e tij, Julia, mundën të shërohen pas



helmimit në muajin mars. Por tre muaj më vonë, i njëjti agjent nervor me emrin Novichok, që shkaktoi sëmundjen e tyre, sëmuri dy njerëz të tjerë. Njëri prej tyre nuk arriti të mbijetojë. Dawn Sturgess vdiq një javë pasi kishte ardhur në kontakt me helmim. Partneri i saj Charlie Rowley është shëruar. "Duart e mia u mbuluan me këtë substancë dhe mund t'ju them se ishte diçka si vaj dhe me shumë pak erë. U trondita shumë kur më thanë se ishte Novichok", thotë Charlie Rowley. Çifti mund të mos ketë qenë në shënjestër, por ata prekën objektet e ndotura me këtë substancë në një qytet jo shumë

larg Sollsbërit, ku u helmuan Skripalët. Kryeministrja britanike Theresa May ka kërkuar hetim të plotë për të dy rastet. "Jam e sigurt se Dhoma e Komunave do të bashkohet me mua për t'u dërguar ngushëllimet tona më të thella familjes dhe miqve të zonjës Sturgess, e cila vdiq mbrëmë. Policia dhe shërbimet e sigurisë po punojnë me urgjencë për t'i sqaruar faktet në këtë hetim që mund të quhet tani hetim për vrasje të qëllimshme", tha May. Hetuesit kanë identifikuar të paktën dy të dyshuar në një videoklip të nxjerrë nga një dyqan ku mund të jetë helmuar çifti. Të dyshuarit besohet të

jenë në Rusi. Britania e ka akuzuar Rusinë se qëndron pas sulmit, të cilin Kremli e mohon me forcë. Por Moskë nuk ka ofruar ndonjë shpjegim se si ky helm ushtarak, i prodhuar në Rusinë Sovjetike, mund të ketë dalë nga vendi. Dhe nuk është hera e parë që një agjent rus është helmuar në Britani. Në vitin 2006 ish-oficeri i KGB-së, Aleksandër Litvinenko, vdiq nga helmimi me polonium. Një hetim britanik arriti në përfundimin se përgjegjëse për vrasjen ishte Qeveria ruse. Britania u ka bërë thirrje aleatëve të saj ta dënojnë Moskën për sulmet e dyshuara

me helm. "Realiteti i thjeshtë është se Rusia ka kryer një sulm në tokën britanike, ku ka vdekur një shtetase britanike. Mendoj se bota do të bashkohet me ne për ta dënuar", thotë Gavin Williamson, sekretar britanik i Mbrojtjes.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë dëbuar shumë diplomatë rusë për helmimin me Novichok. Departamenti i Shtetit tha të mërkurën se Rusia do të ndëshkohet me sanksione për shkeljen e ligjit ndërkombëtar, duke përdorur një agjent nervor vdekjeprurës. Një ligj amerikan i vitit 1991 i bën të detyrueshme sanksionet për shkelje të tilla.

## Përmytet anija në Turqi, mbyten nëntë emigrantë

ANKARA, 9 GUSHT - Nëntë persona kanë vdekur në mëngjesin e së enjtes pasi një anije është përmytur në bregdetin e Turqisë, kanë njoftuar rojat turke të asaj zone, transmeton "Reuters". Katër persona që kanë qenë në anije kanë shpëtuar. Anija është

përmytur në bregun e Provincës Aydın, afër Kusadasi, një destinacion i populluar nga turistët. Në 2015-n Turqia ishte kthyer në një nga pikat kyçe të zbarkimit për më shumë se një milion emigrantë që synonin vendet e

Bashkimit Evropian, shumica prej të cilëve kanë ikur nga konflikti dhe varfëria në Lindje të Mesme dhe Afrikë. Një marrëveshje e vitit 2016 në mes të Turqisë dhe Bashkimit Evropian ka ulur ndjeshëm këtë trend, pasi qindra persona kanë

vdekur duke kaluar nëpër ishujt grekë. Sipas të dhënave në faqen e internetit të Rojës Bregdetare të Turqisë, deri në këtë periudhë të vitit në brigjet turke kanë vdekur 54 persona, të cilët janë cilësuar si "emigrantë të parregullt".





## Mel B finalizon divorcin



**M**el B ka finalizuar divorcin me Stephen Belafone, pas një beteje të gjatë ligjore përplot skandale. Gjykata në Los Angeles ka vendosur që Mel B t'i paguajë faturat ligjore të ish-bashkëshortit 350 mijë dollarë si dhe të ofrojë alimentacion


për vajzën e tyre gjashtëvjeçare Madison, 5 000 dollarë në muaj. Çifti janë ndarë në vitin 2017, kur edhe këngëtarja e akuzoi Belafonte se e kishte rrahur. Këto akuza, të cilat Belafonte i kishte mohuar, janë hedhur poshtë gjatë rastit në gjykatë.

## Jennifer Lopezi, stërvitje edhe në plazh



Jennifer Lopezi është vlerësuar gjithmonë për figurën e saj të përsosur. Dhe për të provuar se ajo punon shumë për t'i ruajtur format trupore,

këngëtarja, edhe pse në moshën 49-vjeçare, është parë e djersitur duke bërë stërvitje intensive në bordin e një jahti luksoz në Itali.



## Kim Kardashiani, forma të përkryera nën fustanin jeshil

**P**asi e kritikoi të motrën Kourtney Kardashian për raportin me ish-in Younes Bendjima në mediat sociale, Kim Kardashian bëri edhe më shumë, duke mos u ndalur me "ngritjen e vetullave" në "Instagram".

Superbomba e modelimit vodhi gjithë vëmendjen e paparacëve teksa u shfaq përkrah Kourtneyt në qendrën tregtare Westfield. Kimi dukej shumë tërheqëse me një fustan jeshil që mbulonte jo siç duhet asetet shpërthyes.

## Sylvester Stallone nis stërvitjen për "Rambo 5"

**R**ambo 5 do të mbërrijë në sallat e kinemave amerikane në vjeshtë të vitit 2019. Sylvester Stallone nuk ka ndër mend të paraqitet në xhirime të papërgatitur. Dhe për të qenë në lartësinë e rolit ikonë për historinë e kinemasë botërore, Sly po stërvitet fort, siç e dëshmon edhe një fotografi e tij në rrjetin social "Instagram" ku shfaqet gjatë një stërvitjeje në palestër.





E rrallë

# Deri në 3 000 euro gjoba për "hajdutët" e rërës në Sardenjë



Autoritetet në Sardenja po ashpërsojnë qendrimin ndaj turistëve që vjedhin rërë nga plazhet e kristalta të ishullit si suvenir, e po vendosin gjoba që shkojnë deri në 3 000 euro.

Sardenja, që është shumë e frekuentuar nga vizitorë të pasur, ka kilometra plazhe të bukura dhe 28 prej tyre kanë fituar statusin e "flamurit blu" për sa i takon pastërtisë.

FOTO E DITES




Një helikopter lëshon ujë mbi një zjarr në Pinet, në rajonin lindor të Spanjës të Valencias. /AFP/

E jashtëzakonshme

# Braktis dasmën për ta shpëtuar të riun që po mbytej

Nuk është menduar dy herë Zac Edwards, 32-vjeçar, teksa ka ndërprerë shërbimin fotografik martesor në plazh për t'u hedhur në ujë dhe për të shpëtuar një 18-vjeçar i cili rrezikonte të mbytej. Dhëndri hero, punonjës në rojën bregdetare të ShBA-së, sapo ishte martuar me Cindyn, 32 vjeçe, e cila mbështeti gjestin e bashkëshortit. Ngjarja ka ndodhur në Alabama.



## BARSOLETA E DITËS



**Burri:** Alo, zemër! Jam në avion, po jemi duke u rrëzuar. Desha të të them se të dua shumë.  
**Gruaja:** Zemër, edhe unë të dua. Për fund, sa e ke kodin e kasafortës?



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

#### "INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird



Në ora 18:20

#### "FUTURE WORLD" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco



Në ora 20:00

#### "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed



Në ora 22:00

#### "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 min

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Vërtet do të keni shpenzime sot, por ato do të bëhen me një qëllim të mirë. Si kohë vere, ju keni zgjedhur të dhuroni shumë.</p>	 <p><b>DEMI</b> Sot jeni gjithë kohën në ndjekje të ndjenjave të forta dhe pasionit, por nuk po arrini dot t'i gjeni. Në mbrëmje do të ndryshoni mendim.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Mëngjes i bukur ky i sotmi. Do të ngriheni në krahët e partnerit për t'i treguar një surprizë. Dita do të vazhdojë këndshëm.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Disa biseda aspak të këndshme do të nxjerrin në sipërfaqe të vërteta komode për ju. Do t'i filloni debatet e shuara tashmë.</p>	 <p><b>LUANI</b> Sot ndjeni gjatë gjithë kohës që një person po ju mbikëqyr. Në një sens të mirë ose të keq do të dëgjoni komente për ju pas disa ditësh.</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> Nëse keni një biznes tuajin, do të jeni shumë më të favorizuar se ata persona që marrin një pagë mujore. Fitimet do të jenë të tëra tuajat.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Sot është miqësia ajo që do të ketë rëndësi për ju. Do të gjeneni pranë një miku të mirë i cili falë jush nuk do të bëjë një gabim trashanik.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Sot keni dëshirë të qëndroni në shtëpinë tuaj dhe do të bëni të pamundurën që mos t'ju shqetësojë askush. Do t'ju shijojë ky pushim.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Sot do të ecni me hapa të ngadaltë, por mjaft të sigurt. Çdo detaj duhet vlerësuar mirë në projektin që po zgjidhni së fundmi.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Kreativiteti juaj sot do të jetë ai që do të zgjidhë një situatë delikate dhe akoma dyshuese. E rëndësishme është që ju u jeni përbajtur fakteve.</p>	 <p><b>UJORI</b> Një periudhë e mirë për ju kjo që po jetoni dhe në çdo moment ndiheni të përkëdhelur. Dhuratat që do të merrni sot, do t'ju lumturojnë.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Dita e sotme është si pangjyrë. Nuk do të ketë asnjë ulje-ngritje humori, thjesht do të rrjedhë dhe ju do të ndiheni të plogësht.</p>



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BALA TOWN - CARMARTHEN TOWN

1

LINFIELD - INSTITUTE FC

1

PADERBORN - REGENSBURG

2

## Në Stadiumin 'Adem Jashari' në Mitrovicë do të investohen rreth 10 milionë euro

"Në bazë të asaj që kam biseduar me ministrin e Sportit dhe atë të Financave, në stadiumin e Mitrovicës do të investohen rreth 10 milionë euro. Do të ndërrohet tërë fasada e jashtme dhe do të modernizohet infrastruktura e brendshme e këtij stadiumi", ka thënë kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, pas vizitës që i ka bërë Stadiumit Olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë



ministrin Gashi.

Ndërkaq kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se Mitrovica, sporti dhe ekonomia janë interesa strategjike të vendit tonë. "Vizitat që po i realizojmë ditët e fundit tregojnë për një përkushtim të qartë tonin për modernizimin e sportit në vendin tonë. Në bazë të asaj që kam biseduar me ministrin e Sportit dhe atë të Financave, në stadiumin e Mitrovicës do të investohen rreth 10 milionë euro. Do t'i ndërrohet tërë fasada e jashtme dhe do të modernizohet infrastruktura e brendshme e këtij stadiumi", ka thënë Veseli. Ndërsa ministri i Financave, Bedri Hamza, ka thënë se Qeveria e Republikës së Kosovës, përveçse do të sigurojë financim të qëndrueshëm për objektet sportive, do të vazhdohet me financimin e projekteve të fuqishme në Mitrovicë.

PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, bashkë me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe ministrin e Financave, Bedri Hamza, kanë vizituar sot Stadiumin Olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë. Në kuadër të kësaj vizite ata kanë parë nga afër situatën e tanishme të stadiumit dhe janë pajtuar që kjo arenë sportive të shndërrohet në stadium të kat-

egorisë së katërt sipas standardeve të UEFA-së. Ministri Gashi ka deklaruar se MKRS-ja është në procedura që edhe stadiumin në Mitrovicë ta shndërrojë në kategorinë e katërt. "Jemi në procedura që ta shndërrojmë stadiumin në Mitrovicë në të kategorisë së katërt në mënyrë që reprezentacioni i Kosovës të ketë mundësi t'i zhvillojë ndeshjet edhe në këtë stadium", ka thënë mes tjerash min-

istri. Ai ka paralajmëruar se do të ketë investime të reja e të mëdha në stadiumin në Mitrovicë dhe Kosova do t'i ketë dy stadione të kategorisë së katërt. "Dalëngadalë po i plotësojmë të gjitha kërkesat dhe kriteret e UEFA-së që Kosova përfundimisht të gjitha t'i zhvillojë në Kosovë, pa pasur

nevojë t'i shfrytëzojë stadione të shteteve përreth", ka thënë ministri, duke shtuar se është shumë i bindur që në vitin 2019 stadiumi 'Adem Jashari' do të jetë i gatshëm dhe të kthehet në kategorinë e katërt. "Do të jetë ndër stadione më të bukura edhe për shkak të kapaciteteve që ka ky stadium", ka thënë

## IPKO, sponsore gjenerale e Superligës dhe Përfaqësueses së Kosovës



PRISHTINË, 9 GUSHT - Kompania IPKO dhe Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) kanë mbajtur sot konferencë për medie, në të cilën është bërë me dije se kjo kompani e telekomunikacionit (IPKO) do të jetë sponsore gjenerale e Superligës dhe Përfaqësueses së Kosovës në futboll për dy vjetet e ardhshëm.

Të gjitha ndeshjet e Superligës që nga tani do të quhen "Ipko Superliga e Kosovës" dhe ato të Përfaqësueses së Kosovës do të transmetohen në platformën "Ipko-Digitalb". Drejtori i IPKO-s, Robert Erzin, ka thënë se është i lumtur që do të jenë sponsor gjeneral i Përfaqësueses së Kosovës pasi,

sipas tij, kjo përfaqësuese ka potencial të madh për suksese në të ardhmen. Ndërsa kryetari i FFK-së, Agim Ademi, ka falënderuar IPKO-n që ka zgjedhur ta mbështesë FFK-në, kurse ka shprehur optimizëm se djemtë e përfaqësueses do ta kualifikojnë Kosovën në Ligën e Kombeve, në ndeshjet që fillojnë në shtator.

## Ekspertët: Të ndalohet goditja e topit me kokë për moshat nën 18 vjeç

LONDËR, 9 GUSHT - Benet Ormalu është një nga ekspertët më të mirë në botë për dëmtimet e trurit. Ai rekomandon kufizimin e gjuajtjes së topit me kokë për lojtarët e futbollit. Madje ai shkon më tej kur thotë se për futbollistët nën 18 vjeç kjo gjë duhet ndaluar kategorikisht. "S'ka asnjë kuptim të kontrolloni me kokën tuaj një objekt që lëviz me shpejtësi të lartë.

Duhet t'i ndalojnë goditjet e topit me kokë, pasi kjo është e rrezikshme", u shpreh doktori. Sipas një hetimi, ish-futbollisti i Anglisë, Xhef Astle, ndërroi jetë në moshën 72-vjeçare pasi vuajti për 10 vjet nga traumat e trurit të shkaktuara nga goditjet e topit me kokë. Vajza e tij ka nisur një fushatë ku kërkon që mjekët ta trajtojnë seriozisht këtë çështje.



## Kovaçiqi prezantohet te Chelsea

Londër, 9 gusht - Pas një këmbënguljeje të gjatë, më në fund Mateo Kovaçiq ka fituar betejën për t'u larguar nga Real Madridi pasi të enjten është prezantuar në Londër te

Chelsea. "Është një kampionat i panjohur për mua dhe natyrisht se do të jetë e vështirë, por jam i bindur se me punë do t'ia dal t'i bind të gjithë. Jam vërtet i emocionuar dhe i lum-

tur që do të luaj për Chelsea dhe shpresoj ta shpërblej besimin e drejtuesve dhe trajnerit", ka thënë Kovaçiq. Ndërsa drejtuesja operative e Chelsea, Marina Granowska,

ka vlerësuar aftësitë e Kovaçiqit dhe ka shprehur bindjen se me cilësitë e tij kroati është ideal për t'i zbatuar idetë e Sarrit në fushën e lojës.







KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS sh.a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C  
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.

09-08-2018

Nr. 5755

Konform me funksionet dhe kompetencat që parashihen me ndryshimet në nenin 17, dhe 25 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr.03/L-087, dt.13.06.2008, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 dt. 20.04.2012; me tej në tekst: Ligji nr.03/L-087) dhe vendimit të datës 31.05.2018, Bordi i Drejtorëve të KEK sh.a, shpall

#### KONKURS PËR VEND TË PUNËS

Titulli i punës: **Drejtor Menaxhues**  
Vendi: Prishtinë  
Ndërmarrja: Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.

Afati i fundit për aplikim: 10 shtator (e Hënë), ora 16:00

#### PËRSHKRIM I NDËRMARRJES

Korporate energjetike e Kosovës Sh.A. (KEK Sh.A.) është aktualisht ndërmarrje publike dhe në strukturën e saj përfshihen minierat e thëngjillit, njësitë gjeneruese të TC A dhe B, financat dhe kontabiliteti, shërbimet e korporatës dhe Auditimi i Brendshëm. KEK Sh.A. aktualisht realizon të hyra vjetore prej rreth 150 milion €.

#### TITULLI I PUNËS: DREJTOR MENAXHUES

Drejtori Menaxhues (DM), duke i raportuar Bordit të Drejtorëve, drejton të gjitha aktivitetet e KEK sh.a. duke koordinuar dhe mbikëqyrë drejtpërsëdrejti punën e menaxherëve ekzekutiv të divizioneve dhe shërbimeve të përbashkëta të KEK sh.a.

Drejtori Menaxhues duhet t'i plotësojë kushtet e kualifikimit dhe të pavarësisë sipas nenit 21, lidhur me nenin 17, të ligjit 03/L-087, i ndryshuar e plotësuar me vone.

Në veçanti, Drejtori Menaxhues duhet të kujdeset për:

- Zhvillimin strategjik të KEK sh.a. dhe udhëheqjen e Korporatës përmes ndryshimeve cilësore dhe me rëndësi esenciale për suksesin e biznesit të saj;
- Transformimin e KEK sh.a. në një ndërmarrje energjetike moderne me afarizëm komercial të vetëqëndrueshëm dhe me orientim drejt konsumatorit;
- Ristrukturimin dhe shthurjen e KEK sh.a. në përputhje me ligjet në fuqi dhe vendimet përkatëse të Qeverisë, dhe
- Optimizimin e proceseve afariste në tërësi të korporatës duke përfshirë numrin optimal të punëtorëve në pajtim me standardet ndërkombëtare për korporata të këtij lloji.

DM ka përgjegjësi të plotë për:

- Operacionet ditore të KEK sh.a. si tërësi;
- Realizimin i bilancit energjetik vjetor të aprovuar;
- Mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mihjeve, dhe të prodhimit të energjisë;
- Planifikimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve infrastrukturore fizike të Korporatës;
- Zhvillimin dhe implementimin e përpiktë të programit për përmirësimin e performancës financiare;
- Përbushjen detyrimeve që burojnë nga traktatet ndërkombëtare, ligjet e Kosovës, licencat e operimeve dhe aktet tjera të ZRrE-së dhe KPMM-se;
- Zbatimin me përpikëri të vendimeve të Bordit të Drejtorëve të Korporatës;
- Përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të planeve vjetore të biznesit të Korporatës, përfshirë administrimin e buxheteve vjetore për operime, mirëmbajtje, shpenzime, paga dhe shpenzime kapitale;
- Emërimin dhe shkarkimin e punonjësve;
- Mirë-administrimin e proceseve të prokurimit dhe transaksioneve financiare;
- Zhvillimin e kapaciteteve njerëzore të Korporatës;
- Shqyrtimin vjetor të performancës dhe pagave të punëtorëve dhe të masave për motivim në punë;
- Përfaqësimin e Korporatës në Kosovë dhe jashtë saj; dhe
- Përgatitjen me cilësi të takimeve të Bordit të Drejtorëve të Korporatës.

DM duhet të ketë:

- Aftësi për udhëheqje për arritjen e objektivave të përgjithshme të KEK sh.a., si dhe aftësi për të marrë vendime të rëndësishme në situata të vështira.
- Aftësi për implementimin e ndryshimeve të nevojshme dhe aplikimin e metodave të reja afariste për përbashkëtimin e sfidave të reja.
- Angazhim të lartë për ndërmarrjen e masave me vendosmëri, objektivitet, kolegialitet dhe efikasitet të duhur.
- Aftësi për zhvillimin dhe ruajtje e marrëdhënieve me kolege e punonjës tjerë që rezultojnë në një zgjidhje optimale për të mirën e Korporatës.
- Aftësi për komunikim efikas me shkrim dhe me gojë me Bordin e Drejtorëve, me ndërvartësit e vet, me konsumatorët, me palët e interesuara, me zyrtarët qeveritar, me media dhe me palët tjera me interes.
- Aftësi për fokusim në çështjet, pritshmëritë dhe problemet të konsumatorëve në mënyrë që ata të kenë përfitime dhe shërbime cilësore në afat të gjatë.
- Zotësi për t'u përshtatur në situata të pa-planifikuara, apo të ndryshuara, fleksibilitet të planeve dhe masat për tu përbashkëtimin me rrethanat e tilla.
- Zotësi të delegimit të autoritetit dhe përgjegjësisë tek bashkëpunëtorët për kryerjen e funksioneve të deleguara.
- Vendosmëri në zbatimin e masave disiplinore për drejtues e punonjës në përputhje me ligjin dhe procedurat e Korporatës.

Kandidati duhet të ketë diplomë universitare në lëmin e administrimit të biznesit, ekonomisë, financave, inxhinierisë apo juridik (së paku 4 vite studime pas shkollës së mesme). Diplomë nga universitetet e jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara. Kandidati duhet të flasë rrjedhshëm gjuhën shqipe ose serbe, dhe, poashtu, të flasë rrjedhshëm gjuhën angleze.

Kandidate duhet të ketë së paku 5 vite përvojë nivel të menaxhimit të lartë. Preferohen individët me përvojë pune në ndërmarrjet korporata tjera me madhësi dhe kompleksitet të lartë, duke përfshirë dhe kërkesat tjera që i parashihet në nenin 17, pika 3 e ligjit 03/L-087, si është ndryshuar e plotësuar me vone.

Aplikacionet duhet të dërgohen të shkruara në njërin prej gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës.

Kërkesa për punësim bashkë me Listën Kontrolluese mund të merren online në [www.kek-energy.com](http://www.kek-energy.com).

Kërkesa për punësim (përfshirë edhe listën kontrolluese, të plotësuar) së bashku me një CV të detajuar, leter motivuese, dëshmi për punësimin dhe kualifikimet, dhe Certifikatën nga gjykata kompetente për mosqenie në hetime jo me e vjetër se 6 muaj duhet të dorëzohen personalisht në zarfë të mbyllur në zyrën e arkives qendrore, Ndërtesa "Toskana", Rr. Nëna Tereza nr. 36, 10000 Prishtina, Republika e Kosovës. Deklarata nën Betim nënshkruhet në momentin e dorëzimit të aplikacionit, Dokumentet dhe dëshmitë e dorëzuara në shpalljet e mëhershme nuk merren parasysh. Letër-Referencat nuk kërkohen të dorëzohen në këtë fazë.

Kandidatët me dokumentacion të mangët, të paplotësuar dhe jo adekuat do të refuzohen.



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS sh.a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C  
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.

09-08-2018

Nr. 5755

PRISHTINË-A

U skladu sa funkcijama i ovlaštenjima predviđenim članom 21, iu vezi sa članovima 17 i 25 Zakona o Javnim Preduzećima (Zakon br.03/L-087 od datuma 13.06.2008. godine, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-111 datuma 20.04.2012 u daljem tekstu: Zakon br. 03/L-087) i odlukom od 31.06.2018. godine, Upravni Odbor KEK-a d.d. objavljuje

#### KONKURS ZA RADNO MESTO

Naziv radnog mesta: **Generalni Direktor**  
Mesto: Prishtina  
Preduzeće: Energetska Korporacija Kosova d.d.

Poslednji rok za prijavu: 10 Septembar (Ponedeljak), vreme 16:00 sati.

#### OPIS PREDUZEĆA

Energetska Korporacija Kosova d.d. (KEK D.D.) je trenutno javno preduzeće, a njegoa struktura uključuje rudnike uglja, proizvodne jedinice TE A i B, finansije i računovodstvo, korporativne usluge i Unutrašnju Reviziju. KEK D.D. trenutno stvara godišnji prihod od oko 150 miliona €.

#### NAZIV RADNOG MESTA: GENERALNI DIREKTOR

Generalni Direktor (GD), izveštavajući Odbor Direktora, upravlja svim aktivnostima KEK-a d.d. koordinacijom i direktnim nadzorom rada izvršnih direktora odeljenja i zajedničkih službi KEK-a d.d.

Generalni Direktor mora ispuniti uslove za kvalifikaciju i nezavisnost u skladu sa članom 21, u vezi sa članom 17 Zakona 03/L-087, sa kasnijim izmenama i dopunama.

Konkretno, Generalni Direktor treba da vodi računa o:

- Strateški razvoj KEK-a d.d. i rukovodstvo Korporacije kroz kvalitativne promene i od suštinskog značaja za uspeh svog poslovanja;
- Transformiranje KEK-a d.d. u savremeno energetska preduzeće sa komercijalno samoodrživim poslovanjem i orijentiranim prema potrošačima.
- Restrukturiranje i razdvajanje KEK-a d.d. u skladu sa važećim zakonima i relevantnim odlukama Vlade, i
- Optimizacija poslovnih procesa širom Korporacije uključujući optimalan broj zaposlenih u skladu sa međunarodnim standardima za Korporacije ove vrste.

GD ima punu odgovornost za:

- Svakodnevno poslovanje KEK-a d.d. u celini;
- Realizacija odobrenog godišnjeg energetskeg bilansa
- Održavanje i razvoj rudnika, i proizvodnju električne energije
- Planiranje i održavanje sistema fizičke infrastrukture Korporacije
- Razvoj i precizna implementacija programa za poboljšanje finansijske performanse;
- Ispunjavanje obaveza koje proizilaze iz međunarodnih ugovora, zakona Kosova, operativnih dozvola i drugih akata RUE i NKRMM.
- Korektno izvršenje odluka Upravnog Odbora Korporacije
- Priprema i nadzor sprovođenja godišnjih poslovnih planova Korporacije, uključujući i upravljanje godišnjim budžetima za operacije, održavanja, troškove, plate i kapitalne izdatke
- Imenovanje i otpuštanje zaposlenih;
- Dobro upravljanje procesima nabavke i finansijskih transakcija
- Razvoj kapaciteta ljudskih resursa Korporacije
- Godišnji pregled poslovanja i plata zaposlenih i mjera za motivaciju na poslu
- Predstavljanje Korporacije na Kosovu i u inostranstvu; i
- Kvalitativna priprema sastanaka Upravnog Odbora Korporacije.

GD treba da ima:

- Liderske sposobnosti za postizanje opštih ciljeva KEK-a d.d., i sposobnost donošenja važnih odluka u teškim situacijama
- Sposobnost sprovođenja neophodnih promena i primena novih poslovnih metoda za suočavanje sa novim izazovima.
- Velika posvećenost preduzimanju mjera sa pravilnom odlučnošću, objektivnošću, kolegijalnošću i efikasnošću.
- Sposobnost razvijanja i održavanja odnosa sa kolegama i drugim zaposlenima što rezultira optimalnim rješenjem u korist Korporacije
- Sposobnost efikasnog pismene i verbalne komunikacije sa Upravnim Odborom, sa svojim podređenima, sa potrošačima, sa zainteresovanim stranama, sa vladinim zvaničnicima, sa medijima i drugim zainteresovanim stranama
- Sposobnost fokusiranja na pitanja, očekivanja i probleme potrošača kako bi imali dugoročne kvalitetne usluge i koristi.
- Sposobnost prilagođavanja ne-planiranim ili promenjenim situacijama, fleksibilnost planova i mera za rešavanje takvih okolnosti
- Sposobnost delegiranja ovlašćenja i odgovornosti na saradnike za obavljanje delegiranih funkcija.
- Odlučnost u primenivanju disciplinskih mera za upravne i zaposlene u skladu sa zakonom i procedurama Korporacije.

Kandidat mora imati univerzitetsku diplomu iz oblasti administracije poslovanja, ekonomije, finansije, inžinjerstva ili prava (najmanje 4 godišnje studije nakon srednje škole). Diplome iz stranih univerziteta treba da budu nostrifikovane. Kandidat treba da tečno govori Albanski ili Srpski jezik, i pored toga da tečno govori Engleski jezik.

Kandidat mora imati najmanje 5 godina višeg menadžerskog iskustva. Poželjne su osobe sa radnim iskustvom u drugim velikim preduzećima/korporacijama sa visokim stepenom složenosti, uključujući i druge uslove navedene u članu 17, tačka 3 Zakona 03/L-087, sa svim kasnijim izmenama ili dopunama. Prijave se moraju podneti napisane na jedan od službenih jezika Republike Kosova.

Formulari za Prijavu i Izjavu pod Zakletvom se mogu preuzeti online na stranici [www.kek-energy.com](http://www.kek-energy.com).

Aplikacija za zapošljenje (uključujući i popunjenu kontrolnu listu), zajedno sa detaljnim CV-om, motivacionim pismom, dokazima o zapošljenju i kvalifikacijama, sertifikatom od strane nadležnog suda da kandidati nisu pod istragom ne starija od 6 meseci, moraju se dostaviti u zatvorenim kovertima u kancelariji centralne arhive, Zgrada "Toskana", ul. Majka Tereza br. 36, 10000 Prishtina, Republika Kosova. Izjava pod zakletvom potpisuje se u trenutku podnošenja aplikacije. Dokumenti i dokazi podneti za prethodna oglašnja se ne uzimaju u obzir. Podnošenje referentnih pisma se ne zahteva u ovoj fazi.

Kandidati sa nepotpunom, neispunjenom ili neadekvatnom dokumentacijom biće odbijeni.





NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br.13 Prishtina, Kosovo  
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Ndërmarrja Hidroekonomike, „Ibër-Lepenc” SH.A. – Prishtinë, publikon këtë

### KONKURS Për plotësimin e kësaj pozite

1. Zyrtar për koordinimin në menaxhim të projekteve dhe hartimin dhe përcjelljen e realizimit të Planit të Biznesit (1)

Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si vijim:

- Ofron përkrahje profesionale për Ndërmarrjen, duke ofruar këshilla për prezantim të duhur;
- Bën përgatitjen, mirëmbajtjen dhe zbatimin e planit të komunikimit në bazë të planit të punës së Ndërmarrjes, duke zbatuar teknikat efektive të komunikimit;
- Përpilimi dhe lëshimi i kumtesave për shtyp, deklaratat, raportet dhe publikimet e tjera për publikun;
- Bën mbikëqyrjen e faqës zyrtare në bashkëpunim me zyrtarin e IT-së të Ndërmarrjes dhe e pasuron me dorëzimin e artikujve aktual tek zyrtari i IT-së për publikim;
- Menaxhon me e-mail adresën për komunikim me publikun;
- Nërsa në bashkëpunim të ngushtë me Njësinë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, pronon dhe shyrton kërkesat fillestare për çasje në dokumente zyrtare si dhe kryen të gjitha përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin për Çasje në Dokumente Publike për Njësinë përgjegjëse për komunikim;
- Përgatit Raportin vjetor për zbatimin e Ligjit për Çasje në dokumentet Publike;
- Kryen të gjitha punët në lidhje me implementimin e projektit, i cili financohet nga Banka
- Botërore apo edhe donator tjerë të mundshëm;
- Merr pjesë në hartimin e dokumentacionit për aplikim në projekte të financuara nga fondet e ndryshme;
- Për punën e tij/saj i përgjigjet Drejtorit të Departamentit për Planifikim dhe Zhvillim;

Marrëdhënia e punës:

- Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimt

Kushtet:

- Ekonomistë i diplomuar - Master;
- Minimum dy vite përvojë pune në profesion;
- Shkathtësi organizative, komunikuese dhe punë ekipore;
- Gatishmëri për të punuar nën presion dhe fleksibilitet në punë;
- Njohuri shumë të mirë në përdorimin Microsoft Office ;

Kërkesës t'i bashkangjiten:

- CV;
- Diplomën;
- Vërtetimin e përvojës së punës:
- Dëshmitë për kualifikimet plotësuese:
- Ekstraktin e lindjes;
- Certifikata që nuk është nën hetime;
- Fotokopja e letër njoftimit;

2. Një punëtor teknik i IT-së SH.E.M. në Shkabaj”

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të punojë me Njësinë e implementimit të projektit (NjIP) të SCADA sistemit në ON dhe SP, të ndërmarrjes;
- Përgjegjës për funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemit SCADA;
- Përgjegjës për funksionimin dhe mirëmbajtjen e RTU-vë;
- Operator në dhomën e kontrollit të sistemit SCADA;
- Të përkrah zyrtarin e IT-së në zgjidhjen dhe mbarëvajtjen e punëve;
